# GAZETA SHQIPTARE






Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7615 E enjte 9 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)






Opinioni i Ditës

Nga DR. XHOI JAKAJ

## Lumturia psiko-biologjike dhe grimcat e saj



Ae dimë ne çfarë është gëzimi dhe ky emocion a na bën të lumtur? Po e nis këtë shkrim, pasi një gazetar i njohur më bëri këtë pyetje dhe unë ndërkohë vazhdoja... Vijon në faqen 21



Opinioni i Ditës

Nga PËRPARIM KABO

## Qyteti, "moderniteti", normaliteti e përgjegjësia

Nëse një hapësirë urbane edhe e rregulluar për së mbari si i thonë fjalës, do të ishte e zbrazur, pa njerëz, pa lëvizje, pa ëndrra dhe pa frymëmarrje, mund të quhej... Vijon në faqet 20-21



Humbi kontrollin e mjetit, arrestohet Rozina Koleci

# Aksident tragjik në Kamëz, "Benz"-i përplas nënën me 2 fëmijë dhe një djalë 29-vjeçar

Ndërron jetë 7-vjeçarja dhe i riu Ramazan Isha. Dëshmitarët: U tmerruam

Nga INA ALLKANJARI

Një aksident i rëndë rrugor ka tronditur kryeqytetin në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Ngjarja tragjike ndodhi në Kodër-Kamëz, ku shoferja Rozina Koleci teksa drejtonte automjetin tip "Benz" me targë AA071UA, ka humbur kontrollin e drejtimit të mjetit, duke... Në faqen 9

LISTA E PARE ME EMRAT E ATYRE QE IU SEKUESTRUAN TOKAT NE VITIN 1945

# BUXHETI, 15 MLD LEKE PER PRONARET, 5 MIJE PERFITUES

ATP ka miratuar kompensimin për dosjet e viteve 2001- 2014, që s'kanë përfituar deri tani asnjë këst. Fondi kompensimit, i ndarë në tri vite



*(Në foto)* Foto ilustruese

Në faqet 6-8

GJYQTARJA E KORRUPTUAR

## Rama: Vetingu mund e duhet të pastrojë llumin e mbështjellë me togën e zezë

Në faqen 3

PYETJA QE SHMANGU

## Haradinaj në Vlorë: Kufijtë nuk do të preken. DASH: Të shmangen retorikat

Në faqet 4-5

DETAJET

## Nis festa në Korçë, birrë e muzikë, dynden vizitorët në qytetin e serenatave

Në faqen 11

"SUMMER PAGES"

## Isida Mollaymeri: Ju tregoj për rivalitetin që ka mes kolegëve, jam e përkëdhelura e Zotit

Suplement

KESHILLA POPULLORE



## Ylli Merja: Efektet çudibërëse të lules së basanit në organizëm për ulcerën e gastritin

Në faqen 12

EKSKLUZIVE/ Zbulohet korrespodenca sekrete e vitit 1963 e udhëheqjes së lartë

# Kur Enveri e Byroja "ngriheshin në këmbë" për "Birra Korça"

Drejtori: Kryeminister, të zgjerojmë kapacitetet se ka shumë kërkesa

Nga DASHNOR KALOÇI

Festa tradicionale e "Birrës Korça", që ka filluar mbrëmë në qytetin e Korçës dhe që zhvillohet për të disatin vit me radhë, ka mbledhur me mijëra e mijëra adhurues të kësaj "pije magjike" jo vetëm nga ai qytet ku dhe është prod-



huar ajo për herë të parë në vitin 1928, por edhe nga qytete të tjera, pa harruar këtu dhe me qindra turistë të huaj që kanë nisur ta frekuentojnë atë festë prej disa vitesh. Por duhet thënë dhe pranuar se "ustallarët" kryesorë të asaj "pijeje simbol"... Në faqet 18-19

KRIZA

AKUZAT

PD: Arkës së shtetit i mungojnë 75 milionë dollarë, rikthim te taksa e sheshtë

# Basha: Qeveria bandë hajdutësh, ja rekordi i ri i "Rilindjes' së Ramës

## "Sa më gjatë, aq më keq për Shqipërinë"

Valentina Madani



Kreu i opozitës Lulzim Basha

**REKORDI**

"Ja rekordi i ri i bandës së hajdutëve 'Rilindja': 45 biznese mbyllen çdo ditë në 2018. Sa më gjatë kjo qeveri, aq më keq për Shqipërinë dhe shqiptarët!", shkruan Basha duke postuar edhe videon në "Twiter" për mbylljen e bizneseve.



Gjatë një seance parlamentare

Kreu i opozitës Lulzim Basha bën përgjegjëse qeverinë për mbylljen e bizneseve. Basha thekson se 45 biznese mbyllen çdo ditë në vendin tonë gjatë 2018-ës. Përmes një video të postuar në profilin e tij në "Twitter" Basha tregon detaje në lidhje me bizneset e mbyllura. Kreu i PD-së shprehet se në vitin 2018, 45 biznese mbyllen çdo ditë dhe për këtë, sipas tij, është përgjegjëse 'Rilindja'. Ndaj, ai shkruan se sa më gjatë të qëndrojë kjo qeveri, aq më keq do jetë për vendin. "Ja rekordi i ri i bandës së hajdutëve 'Rilindja': 45 biznese mbyllen çdo ditë në 2018-ën. Sa më gjatë kjo qeveri, aq më keq për Shqipërinë dhe shqiptarët!", shkruan Basha duke postuar edhe videon në "Twiter" për mbylljen e bizneseve.

**AKUZAT**

Demokratët teksa analizojnë situatën e buxhetit, akuzojnë se arkës së shtetit i mungojnë 75 milionë dollarë, para që nuk janë mbledhur. Ndaj mosmbledhja e taksave dhe mbyllja e bizneseve për periudhën prill-qershor për demokratët janë dy prej arsyeve që i kanë kushtuar arkës së shtetit 75 milionë dollarë më pak për vitin 2018. Sipas nënkryetares së Komisionit të Ekonomisë në Kuvend, Jorida Tabaku dhe këshilltarit për Çështjet Ekonomike në PD, Dorian Teliti edhe aktin normativ që qeveria kaloi në 26 korrik për rishikimin e buxhetit e shohin si arnim të radhës për ekonominë, që sipas tyre perfomon me një borxh në rritje si pasojë e koncesioneve dhe PPP-ve korruptive. "Borxh, të cilin qeveria e fsheh duke mos i deklaruar PPP-të si detyrime në kundërshtim me kërkesat e Bashkimit Europian. Sakaq, borxhi publik në nivelet aktuale e rendit Shqipërinë përpara Gjermanisë, ndër 15 vendet me borxh më të lartë. Shqipëria është e para në rajon për borxhin në një me 70 për qind dhe në qoftë se llogarisim këtu dhe kontratat koncesionare, shkon me 83 për qind", deklaroi deputetja Tabaku. Performanca e dobët fiskale shprehet opozita është një nga arsyet që edhe në aktin normativ, zëri i pagave dhe pensioneve nuk gjejnë reflektim në buxhetin e 2018-ës. "Nuk do të ketë rritje pagash hiqet fondi prej 10 mln dollarë i planifikuar fillimisht për rritjen e pagave. Krijohet fond i veçantë për shpërblimin e pensionistëve në masën 30 milionë dollarë (thjesht për çështje propagande, pasi edhe vitet e mëparshme që nuk ka qenë zë i veçantë, shpërblimi është përballuar nga fondet e ISSH-së", theksoi z.Teliti. E vetmja rrugë për të stimuluar rritjen ekonomike përmes shtimit të të ardhurave në buxhetin e shtetit, për PD-në është rikthimi tek taksa e sheshtë. Sipas Tabakut, futja në TVSH e 11 mijë e 500 subjekteve nuk ishte për të formalizuar ekonominë, por për të favorizuar disa subjekte të mëdha, që operojnë në sektorin e tregtisë, pasi rezulton se janë mbledhur më pak të ardhura nga ky zë. "Sado që qeveria përpiqet të mbulojë dështimin ekonomik, të përdorin raporte ndërkombëtare, e vërteta është ndryshme. Brenda 6- mujorit të parë, arkës së shtetit i mungojnë 75 milionë dollarë. Kjo tregon rritjen e informalitetit, por edhe faktin që bizneset sot janë duke përjetuar vështirësi", u shpreh zj.Tabaku. Kurse sipas Dorian Telitit, përkeqësimi i situatës ekonomike ka ardhur nga politika e gabuar dhe klienteliste e qeverisë, ndërsa theksoi se investimet nuk janë realizuar.

### Ish-kryeministri: Rama 10-fishon çmimin e rrugëve

## Berisha: Në 2009, 1 km rrugë kushtonte 1 mln euro, sot 11 milionë euro



Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje për investimet e qeverisë "Rama" për ndërtimin e rrugëve. Berisha tha se qeveria në këtë sektor po bën vjedhje klamoroze, ndërsa shton se është dhjetëfishuar çmimi i rrugëve. Ai tha se në 2009-ën një km autostradë me 4 korsi kushtonte 1 milion euro, ndërsa sot do të kushtojë sipas tij mesatarisht 10-11 milionë euro. "PPP-të, kostot e dhjetëfishuara të autostradave në një dekadë. Kostot për një kilometër rrugë janë dhjetëfishuar gjatë dekadës, teksa indeksi i çmimeve në ndërtim është rritur me vetëm 4.8%, plus pagat. Ekspertët dhe institucionet ndërkombëtare pohojnë se kostot e larta nuk i justifikojnë përfitimet, që do sjellin këto projekte në ekonomi dhe se nuk janë në përputhje me prioritetet kombëtare. Në dy dekadat e fundit, kosto për një kilometër autostradë është rritur në mënyrë të frikshme, teksa indeksi i çmimeve në ndërtim, inflacioni dhe rritja e pagave nuk i justifikojnë vlerat e larta, që po 'fluturojnë' pa logjikë vit pas viti", shprehet z.Berisha.

Ai përmend se në vitin 2009, një kilometër autostradë me katër korsi, me gjerësi 25 metër, me trotuare dhe ndriçim, ka kushtuar 135 milionë lekë ose, 1 milion euro, ndërsa një e tillë me projektin "One Billion" do të kushtojë mesatarisht 10-11 milionë euro, sipas të dhënave që janë publikuar nga Ministria e Financave në raportet vjetore të monitorimit ndaj Ministrisë së Transporteve. Ndërsa sipas INSTAT, indeksi i çmimeve në ndërtim nga viti 2008 deri më 2017 është rritur me vetëm 4.8%. "Pas vitit 2009, shpenzimet në infrastrukturën rrugore janë shfrenuar totalisht, teksa 2 miliardë euro (të dhëna nga buxheti 2010-2018) të tjera janë investuar, por mungojnë kilometrat. Kulmi arriti në vitin 2016, ku qeveria shqiptare shpenzoi 11 miliardë lekë për të ndërtuar vetëm 5.6 kilometër rrugë nacionale, duke i çuar shpenzimet për një kilometër në 15 milionë euro", theksoi z.Berisha.

**SHPENZIMET**

"Kulmi arriti në vitin 2016, ku qeveria shqiptare shpenzoi 11 miliardë lekë për të ndërtuar vetëm 5.6 kilometër rrugë nacionale, duke i çuar shpenzimet për një kilometër në 15 milionë euro", theksoi z.Berisha.

### Strazimiri: Vjedhja, 100 milionë euro në 6 muaj

Deputeti demokrat, Gent Strazimiri reagoi dje ndaj raportit të KLSH-së, sipas të cilit në 6 muajt e parë të këtij viti janë bërë mbi 100 milionë euro abuzime nga strukturat e qeverisë. Shifrat u bënë të ditura në buletinin e dytë statistikor të vitit 2018, i cili përmbledh rezultatet e të gjitha auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën janar- qershor 2018. Strazimiri rendit disa prej punëve që mund të ishin bërë në infrastrukturë nëse këto para nuk do vidheshin nga zyrtarët e qeverisë. Ai shkon më tej duke thënë se po "vjedhin me urgjencë, si ditën e fundit, sepse po e ndjejnë fundin". "100 milionë euro janë baras me 100 km autostradë, ose 30% e vlerës së Rrugës së Arbrit, ose 3 vjet mirëmbajtje e autostradës së kombit 'Berisha-Rugova'! Kjo vetëm në 6 muaj. Po vjedhin me urgjencë, si ditën e fundit, sepse po ndjejnë fundin!", shprehet z.Strazimiri.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Ministria e Drejtësisë i kërkon KLD-së masa për gjyqtaren e Vlorës: Nisim fazën ndëshkimore

# Rama: Vetingu mund e duhet të pastrojë llumin e mbështjellë me togën e zezë

## Ministria e Brendshme: Gjyqtarja liroi personin e akuzuar për vepra të rënda

Ministria e Drejtësisë i kërkoi dje Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të marrë masa ndaj gjyqtares Herila Çela, e cila me vendimin e saj liroi nga burgu një person me precedentë penalë. Në një konferencë për mediat, zëvendësministri i Drejtësisë, Toni Gogu tha se do të kërkojnë nga KLD masë deri në shkarkimin e gjyqtares Çela. "Gjyqtarja Herila Çela, duke mbyllur sytë para fakteve e provave kuptimplota, ka vendosur masën e sigurisë arrest në shtëpi për një shtetas, i cili është kapur nga policia e Vlorës duke udhëtuar i armatosur, edhe pse ishte nën masën e sigurisë arrest në shtëpi. Ky shkelës i ligjit, 2 herë i arrestuar nga policia në harkun kohor të pak muajve, lihet përsëri në shtëpi nga gjykata, falë gjyqtares Herila Çela, e cila nuk e ka për herë të parë shfaqjen në një pozicion tejet shqetësues në raport me ligjin, gjë për të cilën ajo ka qenë edhe më parë subjekt i inspektimit të Këshillit të Lartë Drejtësisë", - u shpreh ai. Në vijim, zv.ministri Gogu u ndal edhe në gjyqtarët e mbetur në sitën e vetingut. "Pas vetingut, është radha e ndëshkimeve për të gjithë, sepse vetingu nuk është thjesht pastrimi i llumit nga Pallati i Drejtësisë, po mjeti për të garantuar një sistem drejtësie që të bëjë drejtësi. Për të gjithë e pa dallim. Dhe ashtu siç nuk mendohej se kupola e korrupsionit në sistemin e drejtësisë do të shembej e ja ku po shembet, ashtu do të ndodhë më herët se vonë, me daljen e të pandëshkuarve të çdo lloji e niveli përpara ligjit", - përfundoi zv.ministri i Drejtësisë. Kryeministri Rama, ndërsa e postoi në rrjetin social "Facebook" konferencën e zv.ministrit të Drejtësisë, shkroi pak radhë. "Vetingu po zbulon në sytë e shqiptarëve pasuri të paimagjinueshme dhe shkelje ligjore të panumërta nga ana e gjyqtarëve e prokurorëve, që tanimë janë nxjerrë jashtë Pallatit të Drejtësisë e të tjerëve që do t'i pasojnë. Vetingu mund e duhet ta pastrojë deri në fund llumin e mbështjellë me togën e zezë", shkroi dje Rama.




### KUSH ËSHTË GJYQTARJA

Gjyqtarja e Apelit të Vlorës, Herila Çela, për të cilën Ministria e Drejtësisë kërkoi shkarkimin ka edhe "precedentë" të tjerë të marrë në të kaluarën. Përveç skandalit të lirimit të Taulant Beqirit, në vitin 2014-të ministri i Drejtësisë në atë kohë, Nasip Naço kishte kërkuar shkarkimin e saj. Këshilli i Lartë i Drejtësisë dha "vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna" për moszbardhjen e vendimeve gjyqësore në kohë.

### LAZARATI

Kryeministri Edi Rama ka uruar dje 'mirëmëngjesi' me pamjet nga nisja e punimeve për restaurimin e Urës së Kordhocës në Lazarat. "Me lajmin e mirë të fillimit të punimeve për restaurimin e Urës së Kordhocës në Lazarat, trashëgimi kulturore që daton prej vitit 1820, por edhe nyje e rëndësishme lidhëse në luginën e Drinos, ju uroj një ditë të mbarë", tha dje Rama.

**MINISTRIA E BRENDSHME**

Ndërkaq, pas rastit të denoncuar nga Ministria e Drejtësisë ditën e sotme për gjyqtaren e Vlorës Herila Çela, e cila me vendimin e saj liroi nga burgu një person me precedentë penalë, ka ardhur edhe reagimi i Ministrisë së Brendshme. Në një deklaratë për mediat, zëvendësministri i Brendshëm, Besfort Lamallari ka sqaruar edhe historikun e arrestimit të këtij personi. "Sot është sjellë në vëmendjen e medias vendimi i gjyqtares së Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Ky vendim në kufijtë e absurdit ka vënë në pikëpyetje të gjithë luftën dhe sakrificën e bërë deri më tani. Duke pasur besimin se vendimet e gjykatave nuk janë pronë apo interes vetëm i gjyqtarit që jep vendimin, gjejmë rastin të denoncojmë me forcë dhe publikisht historikun e një personi të arrestuar 2 herë brenda pak muajve për vepra të rënda penale dhe i lënë më pas në masën 'Arrest shtëpie', megjithëse herën e dytë kishte thyer këtë masë dhe u kap me armë në makinë", tha zv.ministri Lamallari. "Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit janë të angazhuara në një luftë të pandërprerë kundër paligjshmërisë, kriminalitetit në tërësi dhe që nga vjeshta e kaluar me fokus të veçantë, goditjen e krimit të organizuar dhe grupeve kriminale aktive në vend apo me lidhje jashtë Shqipërisë", tha zv.ministri i Brendshëm. "Në këtë luftë, Policia e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese kanë gjetur partneritetin e fortë dhe të pakufi të agjencive të huaja ligj zbatuese, si dhe mbështetjen e gjerë të opinionit publik. Në këtë përpjekje gjithnjë kemi besuar, me gjithë problematikat, se si pjesë të një trekëndëshi që nuk do të funksiononte pa njëra-tjetrën janë Policia e Shtetit, Prokuroria dhe Gjykata. Këtë e kemi parë si një detyrim absolut ndaj ligjit dhe qytetarëve, pavarësisht se nuk kanë qenë të rralla rastet e pandëshkueshmërisë ndaj elementëve kriminalë nëpër gjykata, apo vendimet e zbutura karshi tyre, sidomos në rastet kur kemi pasur të bëjmë me elemente përsëritës të krimit", u shpreh Lamallari.

## Baza e NATO-s, Koçi: Nuk është momenti për fishekzjarrë, por një moment krenarie

Zv.Ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi duke folur dje për ndërtimin e bazës ajrore të NATO-s në Kuçovë tha se "nuk është momenti për fishekzjarrë, por është një moment krenarie". Koçi nënvizoi se, "ne nga SHBA kemi marre vlerësim pozitiv, por kjo nuk mjafton. Ne duhet të punojmë fort për të rritur standardet. Por kjo nuk arrihet vetëm sigurisht që do ta arrijmë me bashkëpunim". "Kemi edhe ne detyrimet tona nëse do të kemi zgjatjen e pistës do të thotë që do të kemi edhe ne detyrimet tona për të bërë shpronësimet. Por në krahasim me investimin që vjen kostot tona janë minimale. Do të ketë dhe takime konkrete edhe do te vijnë ekspertë për të parë pjesën që do implementohet. Ne kemi dorëzuar një sërë projektesh. Kjo do të jetë baze kombëtare, por edhe e NATOS", u shpreh zv.ministri i Mbrojtjes për "Fax News". "Disa vende anëtare i ofrojnë NATO-s mundësi për të bërë baza apo infrastruktura të tjera ushtarake në vendet e tyre. Ne kemi aplikuar para disa vitesh për bazën e Kuçovës, duke prezantuar një sërë projektesh të cilat mund të financoheshin nga NATO, në shërbim të modernizimit dhe bazës ushtarake. Për t'i shërbyer jo vetëm interesit civil por edhe interesave të sigurisë së përbashkët kombëtare. Procesi ka një sërë shkallësh kualifikimi, ku Këshilli i Atlantikut Verior ka vendosur që kjo bazë e Kuçovës të modernizohet në shërbim të sigurisë kolektive. Do të shërbeje kryesisht për furnizimin e Forcave Ajrore të NATO-s, do të shërbejë si bazë për patrullimin ajror jo vetëm të Shqipërisë, por besojë edhe për vendet fqinje. Pra, janë një sërë interesash të përbashkëta", tha ai. "Por unë besojë se duhet të kuptojmë peshën politike, që do të thotë Shqipëria përbën përparësi në Ballkanin Perëndimor përsa i përket sigurisë dhe paqes. Gjithashtu dëshmon që Shqipëria është një vend aktiv, një vend që kontribuon në Aleancë, nuk është një vend për numër. Nuk është momenti për fishekzjarrë, por një moment krenarie dhe besoj se politika duhet të ndihet mirë. Roli politik i Shqipërisë ka peshë dhe përparësi përsa i përket rajonit. Ky rol duhet të konsideruar në marrëdhëniet tona brenda NATO-s", deklaroi zv.ministri i Mbrojtjes.



## Raporti i "Standart & Poor's", Vasili ironi me Ramën: Shkëlqen me injorancën e tij

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, duke komentuar raportin e "Standart & Poor's" tha dje se kryeministri shkëlqen me injorancën e tij. Në një status në "Facebook", Vasili shkroi se Rama nuk kupton asgjë, por thotë përmendësh atë që i thonë ministrat. "Edhe për vlerësimin e 'Standart & Poor's' prapë e tallën dhe ai i varfri e shkruajti në 'FB' gjithë qejf", shkruan kreu i grupit të LSI. "Kryeministri dihet tashmë nga të gjithë që nuk kupton hiçgjë dhe thotë përmendësh ato që i thonë ministrat. Këta të fundit ia



kanë marrë dorën dhe bëjnë sikur i japin sihariqe dhe ky papagalloset dhe i përsërit gjithë qejf", u shpreh Vasili. "Edhe për vlerësimin e 'Standart & Poor's', prapë e tallën dhe ai i varfri e shkroi në 'FB' gjithë qejf. Ne nuk duam ta tallim kryeministrin, ndaj meqë të paktën shkrim e këndim di, le ta lexojë vetë çfarë thotë 'Standart & Poor's': 'Ne mund të ndërmarrin një veprim vlerësimi negativ nëse do të vërejmë materializimin detyrimeve kontingjente nga projektet e Partneritetit Publik Privat, ose shtimi i borxheve të fshehura nga qeveria', deklaroi 'Standard and Poor's' në vlerësimin e fundit për Shqipërinë. E ka fjalën 'Standart & Poor's' për koncesionet apo për piramidën hajdute financiare të qeverisë, që drejton kryeministri që shkëlqen me injorancën e tij", përfundoi Vasili.

# KUFIRI KOSOVE-SERBI
## DEBATET



**VENDIMI PËR REFERENDUMIN**
Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka theksuar se në rast të arritjes së marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, atëherë fjalën e fundit e ka Kuvendi i Kosovës dhe qytetarët, të cilët duhet të përfshihen drejtpërdrejt në këtë proces, përmes referendumit.



**VUÇIÇ PËR KUFIJTË**
Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç ka thënë se synimi i shtetit të Serbisë është që të fitojë diçka më shumë nga ajo që ka tani Serbia. Sipas tij, është e qartë që kjo do jetë një zgjidhje mjaft e vështirë për të gjithë, por sipas tij, Serbia ka dhënë gjithçka për të qenë një partner i sinqertë. Ai u ka bërë apel serbëve në Kosovë që të mos provokohen, por të rrinë të qetë.



Debatet për korrigjimin e kufijve, SHBA kërkon marrëveshje mes palëve

# DASH: Kosova dhe Serbia të shmangin retorikën negative

## *Tahiri: Të mbyllet sa më shpejt debati*

Pamela Aliaj

Departamenti Amerikan i Shtetit u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë që të shmangin retorikën negative dhe të punojnë së bashku për një marrëveshje, që siguron qëndrueshmëri për të dyja vendet dhe rajonin. Një zëdhënës i Departamentit të Shtetit i tha "Zërit të Amerikës" se, "politika e kësaj administrate është e qëndrueshme: thelbi i çdo marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vijë nga vetë palët. Ne do të vazhdojmë të mbështesim të dyja palët dhe Bashkimin Evropian si lehtësues. Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje që është e zbatueshme, e qëndrueshme dhe nuk krijon paqëndrueshmëri në asnjërin vend apo në rajon. Kjo do të kërkojë largpamësi dhe elasticitet nga të dyja anët. Ne inkurajojmë palët që të marrin pronësinë e plotë të procesit, të ulin retorikën negative dhe të punojnë së bashku në mënyrë konstruktive", thuhet në deklaratën për "Zërin e Amerikës". Ditëve të fundit janë shtuar idetë e hedhura nga të dyja palët për ndarjen tokësore të Kosovës, shkëmbimin e territoreve apo "korrigjimin e kufirit" në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Bisedimet pritet të rifillojnë në shtator dhe do të duhej të çonin në një marrëveshje gjithëpërfshirëse detyruese ligjore për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës, që ka hyrë në vitin e 11-të pavarësisë dhe Serbisë që vazhdon ta kundërshtojë atë. Marrëveshja është kusht për të dyja palët që të përparojnë në rrugën e tyre drejt integrimit në Bashkimin Evropian. Ish-kryenegociatorja në bisedimet e Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë, Edita Tahiri ka theksuar se tema rreth korrigjimit ose shkëmbimit të territoreve mes Prishtinës dhe Beogradit duhet të mbyllet sa më parë. Ajo ka thënë në një intervistë për "Telegrafin" se idenë e shefit të shtetit të Kosovës nuk po e përkrahin institucionet dhe partitë politike në Kuvendin e Kosovës. "Unë jam dhe kam qenë çdoherë kundër shkëmbimit të territoreve ose korrigjimit të kufijve, sepse kjo do t'i leverdiste më tepër Serbisë. Në anën tjetër, për këto tema duhet konsensus kombëtar e që nuk ekziston", ka shtuar Tahiri. Më tej, ajo ka thënë se është paksa e befasuar me heshtjen e Bashkimit Evropian gjatë këtyre ditëve që po diskutohet për temën e shkëmbimit të territoreve. "Unë mendoj se në Serbi përkrahet ideja e ndarjes, por kjo gjë nuk ndodh edhe në Kosovë, sepse për krijimin e shtetit të Kosovës është derdhur gjak, duke e shprehur kështu në mënyrën më të mirë vullnetin e popullit", ka theksuar Tahiri.




Departamenti Amerikan i Shtetit

**EDITA TAHIRI**
"Unë mendoj se në Serbi përkrahet ideja e ndarjes, por kjo gjë nuk ndodh edhe në Kosovë, sepse për krijimin e shtetit të Kosovës është derdhur gjak, duke e shprehur kështu në mënyrën më të mirë vullnetin e popullit", ka theksuar Tahiri.

**DEKLARATA E DASH**
"Thelbi i çdo marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vijë nga vetë palët. Ne do të vazhdojmë të mbështesim të dyja palët dhe Bashkimin Evropian si lehtësues".

**TAKIMI I PARË KOSOVË-SERBI**
Katër vite më parë në Bruksel u takuan për herë të parë kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Ivica Daçiç, takim që hapi rrugën për vazhdimin e bisedimeve mes dy vendeve. Më 19 tetor 2012 u takuan Hashim Thaçi, ish-shef i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe Ivica Daçiç, pasuesi i kriminelit Sllobodan Millosheviç. Takimi u ndërmjetësua nga shefja për politikën e Jashtme të Bashkimit Evropian, Kethrin Ashton.

**TAKIMI I FUNDIT KOSOVË-SERBI**
Në 24 qershor është zhvilluar takimi Mustafa-Vuçiç në Bruksel. Shefja e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, zhvilloi fillimisht një takim me delegacionin e Serbisë të udhëhequr nga kryeministri Aleksandar Vuçiç, e më pas me delegacionin e Kosovës të udhëhequr nga kryeministri Isa Mustafa, pas të cilit u zhvillua takimi i përbashkët me të dy delegacionet. Në krye të bisedimeve ka qenë bashkësia e komunave serbe në Kosovë.

## Daçiç: S'ka zgjidhje për Kosovën pa miratimin e fuqive të mëdha



Ivica Daçiç, ministri i Punëve të Jashtme në Serbi, deklaroi se deri më tani nuk sheh asnjë hap për konsensus nga Prishtina zyrtare, kur bëhet fjalë për statusin e Kosovës. Në një deklaratë për mediat serbe, diplomati serb tha se për çështjet që lidhen me Kosovën nuk do të ketë zgjidhje pa miratimin nga ana e fuqive të mëdha. "Arsyeja e parë është nevoja për kompromis dhe jo për ta mbajtur këtë temë mbrapa me dekada. Arsyeja e dytë është se do theksohet mandati i organeve evropiane. Kjo do të thotë intensifikim i dialogut, por nuk ekziston një zgjidhje e tillë pa miratimin e fuqive të mëdha", tha Daçiç. Lidhur me ndarjen e mundshme të Kosovës, ai tha se edhe 10 vite më parë kishte folur për "përcaktim". "Kam folur për përcaktimin, nuk e kam përdorur termin e ndarjes. Kurrë nuk kam folur për territore. Pyetni njerëzit në veri të Kosovës se çfarë mendojnë për këtë dhe serbët në jug. Ata i përkasin krahinës serbe nën Kushtetutën tonë", pohoi ai.



### Presidenti sqaron qëndrimin e tij: Koha e luftës ka përfunduar

# "Korrigjimi i kufijve", Thaçi: Nuk do të ketë luftë, duhet vetëm konsensus

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi sqaroi dje edhe një herë idenë e tij për korrigjim të kufijve. Thaçi i fundit i është përgjigjur interesit të mediat, ndërsa ka mbajtur një konferencë për shtyp. "Sa i përket asociacionit, marrëveshja e 2013-ës është e qartë. Dhe ajo e vitit 2015 është e qartë, marrëveshje që unë e mbështes. Të gjitha këto marrëveshje janë në mbështetje të Kushtetutës së Kosovës", tha Thaçi. Teksa u ndal tek çështja e kufirit, ai saktësoi se bëhet fjalë për korrigjim. "Synimi nuk është ndryshimi i kufijve, është korrigjimi i tyre, kemi 400 km kufi që duhet të saktësohet me kufirin e Serbisë. Ky proces duhet të jetë i rregullt dhe transparent për llogaridhënie, ndaj shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Nëse ndodh pajtueshmëri e dyanshme, askush s'do të jetë kundër. Koha e luftës ka përfunduar, nuk do të ketë ndarje, nuk do të ketë autonomi. Korrigjim mund të ketë", tha ai. Po ashtu, Thaçi u pyet edhe për faktin se pse ndryshoi mendim lidhur me bashkëngjitjen e Medvegjës dhe Bujanovcit me Kosovën. "Takimi me liderët e Bujanovcit dhe Medvegjës më ka bërë që të ndryshoj mendim. Unë nuk jam njeri që nuk ndryshoj. Në atë kohë nuk e kemi pasur kërkesën e institucionalizuar. Nuk mund të flas në emër të Vuçiçit. Nëse ju brengos e drejta që unë prezantoj për të drejtën e shqiptarëve në Bujanovc, kjo është puna juaj (u drejtohet gazetarëve). Kjo çështje do të prezantohet në tavolinën e Brukselit. Nuk do të ketë ndarje, nuk do të ketë autonomi dhe shkëmbim. Kushdo që të ngrihet, qoftë Vuçiçi apo Daçiçi. Kosova nuk shfaq pretendime territoriale ndaj askujt. Nëse është i nevojshëm ndryshimi i Kushtetutës për bashkëngjitje të Medvegjes, do e ndryshojmë. S'ka të keqe këtu. Nëse Kuvendi i Kosovës nuk është i gatshëm të dekretojë, atëherë nuk është kategori kushtetuese", tha ai.




### Kryeministri i Kosovës viziton Vlorën, shmang përgjigjet për akuzat Thaçi-Berisha, takohet me Pandeli Majkon

# Haradinaj: Kufijtë nuk do të preken, e papranueshme

## *"Shqipëria është atdheu ynë dhe duhet të jemi të gjithë pranë njëri-tjetrit"*

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës së djeshme në qytetin e Vlorës përsëriti qëndrimin e tij sa i përket çështjes së kufirit Kosovë-Serbi. Në përgjigje të interesimit të gazetarëve për temën e shumë debatuar këto ditë të korrigjimit të kufijve të Kosovës, ai nënvizoi se hapja e temave ose e temës së kufijve është e papranueshme për të. "Për fat të keq, për popujt e Ballkanit luftërat kanë qenë tragjike në të kaluarën dhe realiteti i sotëm është krejtësisht rezultat i atyre epilogëve të këtyre luftërave. Prandaj, ne duhet të konsiderojmë arritjet tona pra, Shqipërinë dhe Kosovën shtet ku janë shqiptarë. Hapja e temave ose e temës së kufijve është e papranueshme për mua", nënvizoi ai për gazetarët e mediave të Shqipërisë dhe të Kosovës, që ndoqën vizitën e tij në Vlorë. "Sot ndoshta do të jem më i kujdesshëm me prononcimn tim, realiteti i sotëm është rezultat i atyre luftërave. Hapja e temës së kufijve është e papranueshme. Kufijtë nuk do të preken. Gjithsesi, jam pro të heqim doganën Kosovë-Shqipëri. Me këtë po e devijoj pyetjen me qëllim. Sa i përket referendumit, fatmirësisht jetojmë në demokraci, por ritheksoj së kufijtë janë vendosur me luftë", u shpreh saktësisht Haradinaj. I pyetur për akuzat e forta që Thaçi bëri ndaj ish-kryeministrit shqiptar, Sali Berisha, të cilin e akuzoi për bashkëpunime me Milloshevicin, Haradinaj vendosi që të mos përgjigjej sërish. "I përshëndes të gjithë, pozitë dhe opozitë", tha Haradinaj. "Ajo që unë jam pro deklaratave për këtë qëllim është që në 1 janar të heqim doganën mes Kosovës dhe Shqipërisë", u shpreh ai. I pyetur se çfarë do të ndodhë më tej pas deklaratave të këtyre ditëve, kryeministri Haradinaj theksoi se ato kanë në bazë retorikën politike. "Me qëllim po e devijoj pyetjen tuaj dhe theksoj se ajo është një retorikë politike. Beogradi bëri një retorikë, Prishtina bëri një kundër retorikë, një kundërpërgjigje. Në fund do të thosha se kufijtë nuk lëvizin me fjalë", citoi ai qëndrimin e vet, ndërkohë që shtoi: "Kufijtë janë vendosur si rezultat i ndarjes në epilogët e luftërave". Ai përshëndeti kryeministrin Edi Rama, të gjitha institucionet e Shqipërisë, të gjithë politikën shqiptare edhe atë në opozitë, duke theksuar: "Shqipëria është atdheu ynë dhe duhet të jemi të gjithë pranë njëri-tjetrit". Haradinaj vlerësoi edhe një herë vizitën e tij në qytetin e Vlorës, në atë që e cilësoi "zemrën e shqiptarëve", duke theksuar se do të donte të ishte këtu në çdo ditë të vitit. "Sot jam vlonjat dhe ndihem më shumë se çdo herë shqiptar. Jam në Vlorë, në zemrën e shqiptarëve", u shpreh Haradinaj. Ai falënderoi zotin Dritan Leli dhe stafin e tij, duke e falënderuar në emrin e tij dhe të popullit të Kosovës për mundësinë për të qenë bashkë në nderim të historisë sonë të lavdishme e të çmueshme, por, siç u shpreh ai, "... edhe për mundësinë që ne të ndërtojmë të ardhmen tonë po kaq të lavdishme, duke qenë më afër njëri-tjetrit. Do të jemi çdo herë e më afër". Ai u bëri thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës, të gjithë shqiptarëve, kudo ku janë për të ardhur në Vlorë, për të pushuar në Vlorë. "Për mua, nuk do të kishte ditë të vitit që nuk do të vija në Vlorë, sot jam shumë i nderuar që jam. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës, shqiptarëve kudo ku janë edhe atyre në diasporë që të vijnë në Vlorë, në zemrën tonë. Jam i bindur që duke qenë më afër njëri-tjetrit, e ndihmojmë veten", citoi ai. Nga ana e vet, kryebashkiaku Dritan Leli e cilësoi historike vizitën e Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, në qytetin e Vlorës.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

**VIZITA**

Gjatë vizitës në Vlorë, kryeministri Ramush Haradinaj bëri homazhe dhe vendosi një kurorë në varrin e Ismail Qemalit, në lulishten pranë "Sheshit të Flamurit", ndërkohë që vizitoi edhe Muzeun Kombëtar të Pavarësisë dhe atë Historik të qytetit. Gjatë vizitës së kryeministrit Ramush Haradinaj në Vlorë, ishte i pranishëm edhe ministri i Diasporës, Pandeli Majko.



# Mustafaj: Thaçi të sqarojë publikun, Serbia vend negociator i vështirë

Publicisti Besnik Mustafaj ka bërë analizën e tij lidhur me çështjen e kufijve të Kosovës, që është kthyer në debatin kryesor ditët e fundit. I ftuar në studion e lajmeve në "News 24", Mustafaj tha se është më rëndësi që presidenti Hashim Thaçi ta sqarojë një herë e mirë publikun se si do të procedohet nëse merret një vendim për korrigjim kufijsh. Po ashtu, ai e konsideroi Serbinë një vend negociator shumë të vështirë. "Thaçi duhet të sqarojë para opinionit publik se si e mendojnë këtë bashkim të territoreve të Preshevës me Kosovën, e dyta nëse ka ndonjë dëmshpërblim për Serbinë, dhe pse përkon me insistimin e ministrit të Jashtëm Daçiç, për rregullimet territoriale. Ikja nga Kosova e pjesës veriore është ikje me rëndësi vitale për shtetin e Kosovës, se janë burime ujore atje lart. Kosova thahet nga etja pa ato burime. Ikën pjesë me rëndësi jetike për mbijetesën e Kosovës. Terreni konkret do e komplikojë punën dhe do ketë kundërshti nga brenda. Do ketë pasoja në nivel ndërkombëtar. Jam i bindur se përpjekjet që bëhen në këtë drejtim bëhen për realizimin e një objektivi të shtetit serb prej vitesh", tha Mustafaj.

**Shitje me Ankand te Pare nga Studio Permbarimore L.D.C**

"Ndertese", me siperfaqe 600 m2, me Nr. Pasurie 495/15, Vol 5, fq 83, ndodhur ne ZK 3426 me adrese ne Tufine, Tirane. Regjistruar ne Z V R P P Tirane ne emer te Zyber KUKA. **Çmimi fillestar per shitje eshte 3.360.000 Leke.**

**Data e shpalljes** 01.08.2018
**Data e zhvillimit** 24.08.2018 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Lista e parë me pronarët që do të kompensohen për tokat t sekuestrua në '45-ën

# Buxheti, 15 miliardë lekë për pronarët, 5 mijë përfitues në të gjithë vendin

## *ATP ka miratuar kompensimin për dosjet 2001- 2014*

Ornela Manjani

Qeveria ka miratuar një fond prej 15 miliardë lekësh, të cilat do të shpërndahen për të paktën 5 mijë pronarë, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit të pronës dhe s'kanë marrë deri tani asnjë këst. Fondi është i ndarë në tri vite 2019-2022, i cili rritet progresivisht vit pas viti. Në projektbuxhetin afatmesëm është miratuar fondi për vitin 2019 në vlerën, 4.9 miliardë lekë, për vitin 2020 në vlerën 5.3 miliardë lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 5.4 miliardë lekë. Sipas ligjit në fuqi, pronarëve që u është njohur e drejta për kompensim do të marrin 20% të vlerës në lekë dhe pjesën tjetër 80% kompensim me tokë. Ndërkohë pronarët mund të aplikojnë për të përfituar nga skema për pagesa të përshpejtuara.

**TRI AFATET**

Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

### PËRFITUESIT NË TË GJITHË VENDIN

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Lezhë | Sefer Seferi | |
| 2 | Fier | Maksim Cuko | 6,234,607 |
| 3 | Fier | Zabit Zoto | 5,343,996 |
| 4 | Fier | Bajram Kembora | 982,072 |
| 5 | Fier | VASILLAQ LLUPO | 620,256 |
| 6 | Fier | VELI MANKO | 418,289 |
| 7 | Fier | GURI SEFA | 360,339 |
| 8 | Durrës | Xhemal Veseli | 6,912,162 |
| 9 | Berat | Tajar Shëmilli | |
| 10 | Lezhë | Zef Kola | 516,880 |
| 11 | Fier | Ali Metani, Asqeri Velaj, Burbuqe Murataj, Eqerem Murataj, Esma Murataj (Osmenau), Gezim Metali, Kujtim Met | 4,525,388 |
| 12 | Fier | Qemal Hodaj | 2,088,978 |
| 13 | Fier | Bedri Zeneli | |
| 14 | Fier | Xhevdet Celaj | 260,000 |
| 15 | Lezhë | Kol Mark Prendi | 3,004,202 |
| 16 | Berat | Hysen Helmesi | |
| 17 | Berat | Hysen Helmesi | 464,217 |
| 18 | Berat | Zeqir Pollogati | 262,151 |
| 19 | Berat | Zeqir Pollogati | |
| 20 | Berat | Nazmi Hazisllari | 893,169 |
| 21 | Berat | Skender Veizaj | 9,145,822 |
| 22 | Berat | Shefqet Ago | |
| 23 | Shkodër | Lazer Pal Fushaj | 1,421,337 |
| 24 | Lezhë | Kurt ; Elez Pojani | 11,756,273 |
| 25 | Berat | PETRIT MUHAMETI | |
| 26 | Shkodër | Rexhep Reci | 67,000 |
| 27 | Berat | Myslim Hasan Xhaferri, Sadik Abaz Xhaferri | 1,045,366 |
| 28 | Vlorë | Nexhmi Ballko | 2,385,011 |
| 29 | Vlorë | BesHir Sinani | |
| 30 | Lezhë | Musa Brahim Bushati | 4,180,000 |
| 31 | Lezhë | Jak Mati Pjetri | 1,857,803 |
| 32 | Fier | Tomor Rrapaj | 269,442 |
| 33 | Fier | Lipi Konomi | 817,307 |
| 34 | Fier | Faslli Xhepa | 3,323,717 |
| 35 | Fier | Shefit Zyko | 6,586,061 |
| 36 | Fier | Vasil Naqe | 10,806,420 |
| 37 | Fier | Llaqi Stefani | 1,360,083 |
| 38 | Fier | Pajtim Cobani | 8,143,136 |
| 39 | Fier | Jashar Hoxha | 3,172,500 |
| 40 | Fier | Qazim Mesini | 1,100,222 |
| 41 | Fier | | 2,794,114 |
| 42 | Fier | Skënder Gjeli | 1,676,528 |
| 43 | Fier | Fatbardha Vokopola | 329,797 |
| 44 | Fier | Llazi Sota | 6,756,408 |
| 45 | Fier | Zhaneta Mone | |
| 46 | Fier | Gëzim Kaloshi | |
| 47 | Fier | Kito Dhanili | |
| 48 | Fier | Gëzim Velmishi | 8,464,071 |
| 49 | Lezhë | Emin Lohja | 1,047,830 |
| 50 | Shkodër | Trashegimtaret e tij | 292,195 |
| 51 | Shkodër | Lin Ndrek Lukaj | 5,023,926 |
| 52 | Berat | Ramadan Lala | 550,018 |
| 53 | Berat | Bedri Shmilli | |
| 54 | Berat | Agim Lavdari | 5,311,001 |
| 55 | Berat | Agim Lavdari | 153,582 |
| 56 | Berat | Qani Koroni | |
| 57 | Berat | Idriz Shmilli | 2,310,384 |
| 58 | Berat | Idriz Shmilli | 6,586,360 |
| 59 | Berat | Isa Shmilli | 3,832,064 |
| 60 | Lezhë | Kol Gjok Makaj | 796,351 |
| 61 | Fier | Thoma Kusta | |
| 62 | Fier | Ahmet Haxhiaj, Eduart Haxhiaj, Hekuran Hodaj, Luftije Zeninaj (Hodaj), Nazif Haxhiaj, Rexhep Haxhiaj, Safete | 611,398 |
| 63 | Vlorë | Astrit Kallapodhi | 49,800 |
| 64 | Vlorë | Astrit Kallapodhi | 1,845,543 |
| 65 | Kukës | Shaqir Bilal Morina | 102,268 |
| 66 | Kukës | Ali Vocrri Muca | 1,012,638 |
| 67 | Kukës | Musa Halil Gojani | 8,015,568 |
| 68 | Berat | Selajdin Xhaferi | 294,365 |
| 69 | Berat | Selajdin Xhaferi | |
| 70 | Berat | Kamber Xhaferri | |
| 71 | Berat | Kamber Xhaferri | 4,790,080 |
| 72 | Berat | Bektash Sherri | |
| 73 | Berat | ZAIM SHERRI | 422,350 |
| 74 | Berat | ZAIM SHERRI | |
| 75 | Berat | Xhevdet Lavdari | 223,974 |
| 76 | Berat | Xhevdet Lavdari | |
| 77 | Berat | Hasan Lavdari | 5,340,939 |
| 78 | Berat | Idajet Hada | 5,125,386 |
| 79 | Durrës | Gëzim Shehu | 2,415,248 |
| 80 | Fier | Todi Shkurti | -9,242,131 |
| 81 | Fier | | -107,531,130 |
| 82 | Fier | Zija Vrioni | |
| 83 | Lezhë | Mark Ndoci | 3,007,850 |
| 84 | Durrës | Seit Dollma | 5,766,300 |
| 85 | Durrës | Hamid Kallari | 462,071 |
| 86 | Kukës | Ismail Zenel Zhupi | 138,552 |
| 87 | Berat | Hamit Sherri | 827,016 |
| 88 | Berat | Rufedije Spaho | 4,848,290 |
| 89 | Berat | Rufedije Spaho | 543,686 |
| 90 | Berat | Hajri Kalluci | |
| 91 | Berat | Hajri Kalluci | 2,254,383 |
| 92 | Berat | Bajame Gorezi | |
| 93 | Berat | HAXHIRE SPAHO | |
| 94 | Berat | Dilaver Zaimi | 472,216 |
| 95 | Berat | Dilaver Zaimi | |
| 96 | Berat | Minushe Lulaj | |
| 97 | Durrës | Riza Kamberi | |
| 98 | Shkodër | Dode Pepaj | 522,445 |
| 99 | Tiranë | HASAN BRAHJA | |
| 100 | Lezhë | Dede Daci | |
| 101 | Tiranë | Besnik Shirja, Haxhire Shirja, Reshat Shirja | 3,569,650 |
| 102 | Kukës | Bajram Rrustem Gjongeci | |
| 103 | Vlorë | Andromaqi Loli | 685,149 |
| 104 | Berat | Njazi Saliasi | |
| 105 | Berat | SHEFQET METHOXHA | 578,427 |
| 106 | Berat | Selman Lulaj | |
| 107 | Berat | ALI SPAHO | 4,896,056 |
| 108 | Berat | ALI SPAHO | 1,770,171 |
| 109 | Berat | Bajram Radeshi | 713,361 |
| 110 | Berat | Hajri Kadiu | |
| 111 | Shkodër | Fahri Cen Smajli | 1,391,943 |
| 112 | Shkodër | Vebi Hasani | 1,148,633 |
| 113 | Lezhë | Zek Leci(Marlekaj) | 16,398,545 |
| 114 | Tiranë | SABRIJE CAPI | |
| 115 | Tiranë | KLEANTHI DERVISHI | 22,632,957 |
| 116 | Fier | ZALO HOXHA | 133,218 |
| 117 | Fier | Stavri Naco | 36,400,000 |
| 118 | Fier | Hydajet Leka | 2,797,578 |
| 119 | Fier | Shaqir Xhepexhiu | 621,684 |
| 120 | Fier | Kujtim Gina | 2,889,350 |
| 121 | Fier | KADRI RABIA | 6,216,840 |
| 122 | Fier | Ramadan Alico | 1,769,727 |
| 123 | Fier | ENVER HASANLLIU | 3,641,292 |
| 124 | Fier | Eqerem Dalla | 1,586,635 |
| 125 | Fier | RAZIE TURKU | 819,853 |
| 126 | Fier | Bahrie Taullau | 12,740,000 |
| 127 | Fier | ENVER LICI | 1,085,205 |
| 128 | Fier | ATHINA PUKA | 571,357 |
| 129 | Fier | Isan Toro | 8,454,902 |
| 130 | Fier | Aqif Xhepexhiu | 2,486,736 |
| 131 | Fier | Esat Manoku | 4,038,578 |
| 132 | Fier | Andrea Sylari | 6,811,880 |
| 133 | Fier | Mustafa Murrizi | 1,670,258 |
| 134 | Fier | Seit Kurti | 6,736,686 |
| 135 | Fier | Mihallaq Lako | 4,550,000 |
| 136 | Berat | Adil mUsai | 0 |
| 137 | Fier | Abedin Toshkollari | 6,862,207 |
| 138 | Fier | Vait Arapi | 469,519 |
| 139 | Fier | Nazmi Licka | 1,986,428 |
| 140 | Fier | Celik Spahiu | 361,169 |
| 141 | Fier | Qemal Lufta | 548,562 |
| 142 | Fier | Qemal Dervishi | 361,169 |
| 143 | Fier | Vesel Topulli | 577,870 |
| 144 | Fier | Hasan Sefa | 722,338 |
| 145 | Fier | Adem Kurti | 5,486,213 |
| 146 | Shkodër | Asim Man Hysa | 562,086 |
| 147 | Lezhë | Manuel Nik Shabi | 1,561,350 |
| 148 | Lezhë | Pal Gjin Kolziu | 5,710,080 |
| 149 | Lezhë | Manuel Nik Shabi | |
| 150 | Lezhë | Prek Ivanaj | 2,081,800 |
| 151 | Lezhë | Martin Gjeka | 3,305,898 |
| 152 | Shkodër | Nazim Grenazi | |
| 153 | Shkodër | Xhemalije Puka | 2,200,140 |
| 154 | Lezhë | Gjovalin Nikaj | 12,970,650 |
| 155 | Lezhë | Lek Turkaj | |
| 156 | Lezhë | Vitore Pjetrushi | |
| 157 | Lezhë | Ded Marku | 2,891,135 |
| 158 | Shkodër | Pal Dodaj | -2,504,940 |
| 159 | Lezhë | Ismail Bajram Hasani | 2,107,000 |
| 160 | Lezhë | Gjek Tahiri | 16,257,612 |
| 161 | Berat | Luftar Bega | |
| 162 | Berat | MALIQ BAZE | |
| 163 | Berat | MALIQ BAZE | 2,050,681 |
| 164 | Berat | Petref Jashar Shmilli | |
| 165 | Berat | Ali Hoxha | 902,097 |
| 166 | Berat | Ali Hoxha | |
| 167 | Berat | Selim Kelliçi | 1,685,600 |
| 168 | Berat | Qemal Zaimi | 4,607,505 |
| 169 | Berat | Murat Dine Hajdari | 6,573,840 |
| 170 | Berat | Hamdi Izet Kulli | 2,662,947 |
| 171 | Berat | Dervish Qama | 150,012 |
| 172 | Berat | Baftjar Zylali | 3,130,400 |
| 173 | Shkodër | Engjell Ceka | 644,140 |
| 174 | Korçë | Andrea Jakova | 1,406,423 |
| 175 | Korçë | Arefi Xhone | -50,733 |
| 176 | Korçë | Hamza Hysenlliu | 118,850 |
| 177 | Korçë | Irena Haxhi | 126,420 |
| 178 | Shkodër | Mhill Majnishta | 0 |
| 179 | Korçë | Bashkim Lipo | 120,000 |
| 180 | Durrës | Ymer Dervishi | -1,428,125 |
| 181 | Durrës | | 33,249,468 |
| 182 | Lezhë | Vat Ivanaj | 613,709 |
| 183 | Berat | Stavri Sholla | 290,073 |
| 184 | Berat | AGUR DURAKU | 333,858 |
| 185 | Berat | Lili Buçka | 3,141,822 |
| 186 | Berat | Sami Arif Haderi | 1,057,217 |
| 187 | Berat | Ramadan Qazim Sinani | |
| 188 | Berat | Ramadan Qazim Sinani | 1,613,190 |
| 189 | Berat | Muke Tusha | |
| 190 | Berat | Muke Tusha | 463,064 |
| 191 | Berat | Qani Zaimi | |
| 192 | Berat | Selman Koprencka | 3,067,661 |
| 193 | Korçë | Edmond Selenica | 186,737 |
| 194 | Korçë | Pandi Qiriako | 191,558 |
| 195 | Korçë | Bukuri Jakupi | 191,558 |
| 196 | Berat | Jaho Brisku | 3,173,430 |
| 197 | Berat | Vasil Jorgji Tavani | 3,881,326 |
| 198 | Berat | Alim Bega | 759,846 |
| 199 | Berat | Raku Buçka | 3,078,608 |
| 200 | Berat | Hysen Hito | 954,368 |
| 201 | Berat | Hyda Nazmi Kalluçi | 3,986,231 |
| 202 | Berat | Hyda Nazmi Kalluçi | |
| 203 | Berat | Engjell Shahu | |
| 204 | Berat | Rushan Leshi | 6,810,944 |
| 205 | Berat | Fatmir Bilçari | 2,819,244 |
| 206 | Berat | Tefik Shyqyri Molishti | 186,085 |
| 207 | Berat | NAFIE DURRO | 1,012,520 |
| 208 | Korçë | Theologji Menkshi | 0 |
| 209 | Durrës | Hysen Kasmi | 4,589,292 |
| 210 | Fier | Nexhip Duce | 244,682 |
| 211 | Durrës | Gani Dija | 284,199 |
| 212 | Durrës | Hysen Kertusha | 3,932,236 |
| 213 | Durrës | | 308,559 |
| 214 | Durrës | Ali Guza | 505,243 |
| 215 | Berat | THOMA HAXHISTASA | 390,971 |
| 216 | Berat | Ramadan Selman Kokoshi | 6,249,287 |
| 217 | Berat | Nuri Bakillari | 617,179 |
| 218 | Berat | Resul Hoxha | 1,514,767 |
| 219 | Berat | Resul Hoxha | 700,348 |
| 220 | Berat | ZENEL YZEIRI | 721,776 |
| 221 | Berat | Kamber Zaimi | |
| 222 | Berat | Kamber Zaimi | 730,798 |

223 Berat Xhevit Ibro 239,539
224 Berat Xhevit Ibro 110,672
225 Berat Aleksander Vesho 1,392,649
226 Berat Hazbi Demir Toska 2,461,918
227 Berat Refat Bajraktari
228 Berat Refat Bajraktari 426,299
229 Durrës Kadri Dervishi 525,859
230 Durrës Bashkim Berishaku 733,806
231 Durrës Kapllan Milaqi 988,833
232 Durrës 325,250
233 Durrës Qazim Lila 2,182,019
234 Lezhë Simon Ivanaj
235 Lezhë Pjeter Prela
236 Shkodër Kole Arra -58,150,470
237 Shkodër Bashksia Islame e Shqiperise Myftinija Shkoder 26,597,248
238 Berat Gani Mekollari 1,123,986
239 Lezhë Shtjefen Vas Preçi 7,460,782
240 Berat Mehmet Kadri Shegani 286,184
241 Berat Dhora Pjetri
242 Berat DAFINA GALICA 739,520
243 Berat Lili Thana 322,748
244 Berat Sulejman Haxhillari 551,509
245 Berat Xhafer Kamber Qamo 1,201,757
246 Berat Hajrulla Hysi 1,116,497
247 Berat Hajrulla Hysi
248 Berat Shpetim Pellumbi
249 Berat Majre Tajfur Kapedani ( Shuka ) 1,234,004
250 Korçë Ramadan Bregu -12,384
251 Shkodër Bashkesia Islamike Shqiptare Myftinija Shkoder 31,065,150
252 Durrës 317,600
253 Vlorë Barjam Tozaj 1,092,863
254 Vlorë Kostaq Basko 259,202
255 Vlorë 1,219,427
256 Vlorë Jorgji Nushi 3,883,042
257 Vlorë Petrit Cobo
258 Vlorë Selfo Rrapushi 4,664,500
259 Vlorë Ali Bestrova 1,329,089
260 Vlorë Jazo Rama 1,395,702
261 Vlorë Guri Shyti 611,753
262 Fier Nikollaq Rista 366,858
263 Fier Gjergji Joti 3,132,777
264 Fier Arif Troka 7,296,926
265 Fier Uani Stavri 5,072,785
266 Fier Kostandin Mërkuri 4,122,094
267 Fier Skënder Veizi
268 Fier Lukan Bare 5,301,855
269 Fier Rrapo Agaj 8,796,300
270 Fier Jorgji Karaja 5,983,695
271 Fier Gjergji Dhima 6,484,577
272 Fier Kristaq Profka 422,940
273 Korçë Florie Qari 181,858
274 Korçë LLAMBI SHAMIA 14,005
275 Fier Fani Gjino 4,229,400
276 Korçë Dilaver Xhuti 16,221
277 Durrës
278 Fier Osman Sadushi 1,296,643
279 Fier Sabedin Alliaj 1,998,392
280 Fier Ramadan Shabani 2,063,947
281 Fier Sile Sota 5,678,006
282 Fier Patos Gjilani 2,114,700
283 Fier Ilia Doraci 2,004,736
284 Fier Emine Bibolli 1,133,479
285 Fier Banush Kanani 5,642,665
286 Korçë GENCI TRENI 523,388
287 Korçë Sllave Ilo
288 Korçë Skender Kolaneci 1,403,428
289 Fier Mihal Valle 2,948,496
290 Fier Haki Zeqaj 2,350,489
291 Fier Vedat Como 8,076,644
292 Fier Arshi Faria 3,569,272
293 Fier Kasem Çeribashi 2,752,886
294 Fier Pandeli Lengu 4,047,536
295 Fier Thoma Mefsha 5,137,900
296 Shkodër Agim Teofik Kallogjeri
297 Shkodër Bashkesia Islamike 50,410,653
298 Durrës 2,949,180
299 Gjirokastër Petraq Popli -134,510
300 Fier Myqerem Grëmi 2,952,121
301 Fier Agim Jashari 1,009,517
302 Fier Nuredin Gremi 1,484,519
303 Fier Vangjel Bare 5,385,235
304 Fier Fecor Lamaj 2,960,066
305 Fier Skënder Ruzhdia 1,178,235
306 Fier Marie Rista 3,432,158
307 Fier Farushe Peja Hoxha 509,794
308 Fier 3,015,940
309 Fier Petraq Kuqi 2,664,522
310 Fier Sotira Xoxa 7,571,683
311 Fier Jashar Boriçi 2,753,158
312 Fier Sabush Vrapi 4,249,520
313 Fier Nikollaq Llupi 7,189,980
314 Fier Valentina Shehu 5,859,532

315 Fier Vangjel Andoni 585,772
316 Fier Mihal Prifti 181,018
317 Fier Llazi Doko 7,718,531
318 Fier Hekuran Çobaj 4,141,610
319 Tiranë YLLI DIBRA 17,398,000
320 Lezhë Bajram Ismail Hasani
321 Berat SHAHIN BAKO
322 Berat Hysen Hajderi 1,724,896
323 Berat Mersin Xhemal Qevani 1,348,642
324 Berat Hilmi Cipi
325 Berat Agim Lakra 3,546,654
326 Berat Ramiz Paja 1,150,397
327 Berat Zeqir Abas Laze 3,015,600
328 Berat Kadri Çela 1,325,464
329 Berat Nazmi Xhaja 349,009
330 Berat Qazim Hoxha 2,706,816
331 Berat Tomorr Jakllari 1,725,595
332 Berat Qazim Buda 323,247
333 Berat Levend Gjergjani 5,751,924
334 Berat Maksim Kaci 766,094
335 Berat Muharrem Nonaj 1,186,800
336 Durrës Shaban Jakova
337 Durrës Sabri Kapexhiu 4,712,390
338 Durrës Gëzim Tivari
339 Durrës 4,744,150
340 Fier Areti Sema 3,321,024
341 Fier Filip Korraqe
342 Fier Kujtim Pagria 15,445,608
343 Shkodër Hajrullah Gruda 2,970,000
344 Korçë Hamdi Hoxha 294,129
345 Fier Marie Daka 1,349,166
346 Fier Abaz Libohova 11,655,905
347 Fier Areti Hasbra 3,829,556
348 Fier Sokrat Sema 5,355,151
349 Fier Qqerim Hyka 3,005,355
350 Fier Nushi Krasniqi 1,868,076
351 Fier Maliq Duraj 4,101,468
352 Fier Hodo Fejzulla 3,151,756
353 Fier Adem Bogdani 1,006,493
354 Fier Diella Gjeka 954,163
355 Fier Llazi Ndone 5,853,254
356 Fier Pandi Pjetri 467,019
357 Fier Flora Muslihaka 5,820,361
358 Fier Tafil Nasufi
359 Fier Kristaq Cuni 7,312,969
360 Fier Arif Zeqo 1,016,530
361 Fier Kujtim Pagria 3,798,421
362 Shkodër Enver Mani 1,098,699
363 Shkodër Hajrulla Halili 2,366,230
364 Fier Thoma Kusta 3,460,412
365 Korçë Pellumbesha Selenica 560,423
366 Korçë Musa Lenja 1,249,467
367 Fier Todi Pjetri 8,767,503
368 Fier Fatmir Hoxha 1,067,472
369 Fier Aristir Rudi 725,881
370 Fier Fadil Kollcaku 533,736
371 Fier Asprie Zaka 1,088,228
372 Shkodër Fahri Met Qoshja 996,307
373 Shkodër Zef Prela 507,049
374 Fier Mero Canaj 372,192
375 Berat Jorgji Nushi 749,555
376 Berat Neshat Jonuz Berzheshta 1,009,295
377 Berat Avdyl Sanxhaku
378 Berat Avdyl Sanxhaku 543,090
379 Berat Haki Spahiu 800,604
380 Berat Haki Spahiu
381 Berat Gani Hasa 295,384
382 Berat Gani Hasa
383 Berat Qamil Bektashi 529,740
384 Berat Qamil Bektashi
385 Berat Hasan Hoxha 417,218
386 Berat Hasan Hoxha 4,981,536
387 Berat Qemal Halili 1,039,080
388 Berat Rustem Mançe 1,667,397
389 Berat Rustem Mançe 474,432
390 Berat SOTIRAQ KULE 177,408
391 Berat Rustem Shyqyri Gorica 859,168
392 Berat Thellenza Ismail Kashari ( Pulaj ) 5,426,316
393 Berat Nurije Dura 1,493,756
394 Berat ILIA sotir ANGJELIU 314,904
395 Vlorë Xhezmi Ismailaj 445,773
396 Vlorë Petro Qarri 3,723,253
397 Vlorë Fatmir Hakani 936,707
398 Vlorë Leonard Tefa 6,235,816
399 Fier Arqile Gjika 658,274
400 Fier Idriz Bregu 820,698
401 Fier Aleks Çobo 3,552,428
402 Fier Vemigjar Laze 4,510,317
403 Fier Fatmir Terbunja 573,381

404 Fier Sali Shoshi 711,648
405 Fier Marjana Shtëmbari
406 Fier Kristaq Decolli 1,003,424
407 Fier Gëzim Gore 194,280
408 Fier Muhamet Beqiraj 761,463
409 Fier Kiu Paloli 320,242
410 Fier Vera Sharra 266,868
411 Fier Albert Pecollari 640,483
412 Shkodër Meçe Kalej 3,619,353
413 Fier Themi Panajoti
414 Fier Bahar Zyberi
415 Korçë Ramadan Prizoi 164,800
416 Korçë Xhevit Buna 100,000
417 Korçë Elpiniqi Nicidhi 240,768
418 Lezhë Anton Marku 4,975,872
419 Korçë Sotiraq Dino -873,750
420 Fier Rapush Xhafa 4,236,355
421 Fier Isuf Hoxha 1,262,694
422 Fier Myfit Shehaj 4,420,838
423 Fier Skënder Çepele 7,063,712
424 Fier Ali Mukaj 2,695,334
425 Fier Xhevit Harruni 3,216,893
426 Fier Bajram Bushi 1,003,981
427 Gjirokastër Ali Karalliu 1,030,093
428 Fier Toli Shollo 6,891,315
429 Fier Luftar Buzi 9,341,629
430 Fier Faik Driza
431 Kukës Hajredin Bajram Dushaj 315,392
432 Kukës Zenel Hamz Gjonaj 82,790
433 Kukës Sadik Shaban Ndreaj 488,858
434 Lezhë Prek Mirashi 4,462,234
435 Fier Hamide Kullundra
436 Fier Sofie Cuco 506,880
437 Fier Shyqyri Banushi 433,889
438 Fier Ali Mukaj 1,216,512
439 Fier Liljana Zere 574,464
440 Fier Aleks Kristo 385,229
441 Fier Xhelal Ruci 405,504
442 Fier Adi Hyseni 540,672
443 Korçë Farik Koci Mecaj
444 Korçë Vasfi Haruni 400,000
445 Durrës Rifat Hamdi Kazazi
446 Durrës Haxhi Gashi -17,738,700
447 Durrës Osman Kertesa 19,155,000
448 Durrës
449 Durrës Nazmije Luska, Qemal Destani, Sadete Destani , Violeta Destani
450 Durrës Shaban Gërdeci -763,442
451 Fier Andrea Pepa 413,952
452 Fier Viktor Goga 283,853
453 Fier Igli Pogace 304,128
454 Fier Luçi Sila 236,544
455 Fier Rustem Myftari 644,751
456 Fier Daut Bonjaku 25,786,000
457 Berat Hair Brahim Kondi 153,965
458 Berat Hair Brahim Kondi
459 Berat Yzeir Jaupi 460,678
460 Berat Hajri Feim Turhani 1,361,808
461 Berat Hajri Feim Turhani 2,108,621
462 Berat Xhelal Bido Kaci 858,542
463 Berat Petrit Korbi 709,226
464 Berat Xhite Çeta 204,298
465 Berat Xhite Çeta 3,694,592
466 Berat Shefqet Axhem Qato 1,007,386
467 Berat Shefqet Axhem Qato
468 Berat Haki Sanxhaku 941,294
469 Berat Dervish Shuaipi 3,756,769
470 Berat Dervish Shuaipi 902,804
471 Berat Gjyrxhi Sanxhaku 2,559,181
472 Berat Gjyrxhi Sanxhaku 1,061,597
473 Berat Namik Muhedin Shehu 515,328
474 Berat Avdurraman Muhamet Nallbani 760,827
475 Berat Ramadan Hekuran Vavla 1,372,378
476 Berat Avdurraman Hoxha 440,986
477 Berat Vafku Mysliman 887,040
478 Lezhë Ndue Gjok Ndoj
479 Tiranë ESAT XHIXHA
1 Fier Xhezo Hazizi 1,136,035
2 Fier Drita Mema 5,320,916
3 Fier Riza Shehu
4 Fier Brahim Korreshi, Rrahman Korreshi 1,421,500
5 Fier Petrit Cela 1,328,517
6 Durrës Shaban Babaj 0
7 Lezhë Pjeter Mark Gjetja
8 Korçë Zamir Cenolli 306,000
9 Korçë Kostaq Angjeli 318,000
10 Korçë Fiqiri Llaho 1,050,520
11 Korçë Gezim Shkullaku 159,995
12 Lezhë Dufije Dungaj 932,131
13 Durrës Niko Felahi
14 Durrës Lutfi Hasa 11,080,000
15 Fier Sofije Qarri 7,491,386
16 Fier Zoi Prifti 725,509
17 Fier Zeliha Morina 357,317

18 Fier Ilia Oroshkiviç 199,742
19 Fier Sokrat Sota 3,653,067
20 Kukës Rexhe Mehmet Hasani 160,909
21 Lezhë Nosh Simon Gilal 5,025,866
22 Fier Irakli Dhana 5,825,820
23 Fier Gjena Gjini 2,718,716
24 Fier Pandeli Shkurti 5,668,245
25 Fier Hava Vuthaj
26 Fier Zeliha Morina 6,990,984
27 Fier Petraq Shanko
28 Tiranë XHEVDET SPAHIU -23,130,300
29 Vlorë Tanush Shyti 243,436
30 Vlorë Halim Halla
31 Vlorë Kristaq Hyso 3,391,876
32 Berat Galip Polovina 5,683,434
33 Berat Zenel Lamçe 411,969
34 Berat Mylazim Mustafa Sulçe 938,352
35 Berat Jani Zoi Kerri 642,390
36 Berat Jani Zoi Kerri
37 Berat Hamite Oboni 717,519
38 Berat Myslim Hasan Xhaferri, Sadik Abaz Xhaferri
39 Berat Bardhyl Hysen Haxhialiu 2,450,839
40 Kukës Mehmet Tahir Kerxhaliu 914,368
41 Shkodër Gjyste Gavoçi 290,054
42 Shkodër Dode Rroku 0
43 Gjirokastër Drita Llakaj 223,379
44 Korçë Nezir Ravolli 1,480,000
45 Korçë Çlirim Hoxha
46 Korçë Sezai Tahiri 1,230,190
47 Korçë Celnik Mara 186,120
48 Korçë Dhanai Cingo 1,558,391
49 Kukës Ndue Kol Markaj 162,546
50 Korçë Xheviko Vrioni ( Kollcinaku ) 182,250
51 Fier Zoica Shkurti 662,021
52 Fier Dano Dhjari 7,906,503
53 Fier Kristaq Rezhda 1,275,441
54 Fier Zeqir Shehu 876,204
55 Fier Urani Sota 5,513,815
56 Fier Izet Bunati 4,631,364
57 Fier Dilaver Buzi 2,806,968
58 Fier Ritvan Resuli 7,997,100
59 Fier Tafil Nasufi 993,628
60 Fier Kostandin Lala 1,085,937
61 Kukës Fize Kasem Beluli 77,885
62 Kukës Hysni Shaqir Gjana 458,547
63 Kukës Ismail Ahmet Batusha 732,558
64 Kukës Selim Xhem Truni 411,852
65 Kukës Halit Myftar Gjana 495,332
66 Fier Xhezmi Koka 1,730,712
67 Kukës Bislim Xhafer Hallaçi 281,709
68 Fier Hekuran Shima
69 Korçë Kostandina Miti 30,792
70 Lezhë Abdulla Dibra
71 Shkodër Pjeter Mandi 196,103
72 Lezhë Ded Mekshi 1,919,450
73 Fier Tafil Gremi 3,041,401
74 Fier Mustafa Tabaku 438,102
75 Fier Xhevat Mece 6,686,745
76 Fier Dhimitër Semini 4,517,318
77 Fier Kalem Çela 2,713,020
78 Fier Sabri Ibraliu 1,476,195
79 Fier Ramadan Sina 2,895,853
80 Fier Ismail Korreshi
81 Shkodër Nexhmije Bushati 550,035
82 Elbasan ILMI PLAKA 805,072
83 Gjirokastër Vasil Cavo -320,736
84 Korçë Thanas Dudo 728,344
85 Korçë Naxhi Bujari 1,424,916
86 Korçë Hasan Demir 484,416
87 Durrës Tomorr Kokomani
88 Gjirokastër Shkëlqim Ferrati 48,720
89 Gjirokastër Gezim Ibrahimi
90 Gjirokastër Syrja Ibrahimi
91 Gjirokastër Leonard Papa 1,150,300
92 Fier 2,346,280
93 Fier Vesel Ahmeti 1,401,926
94 Fier Caush Coku 4,450,560
95 Fier Ridvan Resuli 10,323,352
96 Fier Sterjo Buli
97 Fier Rexhep Çoku 5,871,109
98 Fier Hajdar Trashi 140,426
99 Fier Anastas Daja 1,680,004
100 Fier Brahim Arapi
101 Fier Naim Hoxha 973,560
102 Fier Arjan Shefa 400,550
103 Fier Vehip Arapi
104 Fier Tanush Ruli 350,482
105 Lezhë Dalip Kau 686,276
106 Berat Burhan Lamce
107 Berat Xhemal Mustafai 1,468,685
108 Berat Isa Lamce
109 Berat Mustafa Lamce
110 Berat Muharrem Ali Mustafaj 734,342








Humbi kontrollin e mjetit, arrestohet shoferja Rozina Koleci. Dëshmitarët: U tmerruam

# Aksident tragjik në Kamëz, "Benz"-i përplas nënën me 2 fëmijë dhe një 29-vjeçar

## Ndërron jetë 7-vjeçarja dhe i riu Ramazan Isha

Ina Allkanjari

Një aksident i rëndë rrugor ka tronditur kryeqytetin në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Ngjarja tragjike ndodhi në Kodër-Kamëz, ku shoferja Rozina Koleci teksa drejtonte automjetin tip "Benz" me targë AA071UA, ka humbur kontrollin e drejtimit të mjetit, duke u përplasur me një biçikletë. Pas kësaj, makina ka përplasur edhe një nënë me dy fëmijë të mitur. Si pasojë e përplasjes së fortë ka ndërruar jetë njëra nga vajzat, një 7-vjeçare dhe çiklisti i identifikuar si Ramazan Isha, 29 vjeç. Ndërkohë janë transportuar menjëherë në spital nëna e dy vajzave, Valbona Ndreu, 29 vjeçe dhe vajza tjetër 6-vjeçare. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", drejtori i spitalit të Traumës, Gjovalin Bushi, shprehet se gjendja shëndetësore e nënës dhe vajzës së mitur është stabilizuar dhe se ndodhen jashtë rrezikut për jetën. "Nëna dhe vajza e mitur ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Janë duke iu nënshtruar disa ekzaminimeve për të bërë disa kontrolle të detajuara", tha drejtori i spitalit, Bushi. "Më datë 08.08.2018, rreth orës 08:40, në rrugën e Kamzës, tek shinat e trenit, shtetasja R.K., ka humbur kontrollin e drejtimit të mjetit me targë AA071UA, duke u përplasur me një biçikletë dhe më pas me këmbësorë. Si pasojë e përplasjes ka ndërruar jetë shtetasja E. N., 7 vjeçe dhe janë dërguar në spital për ndihmë mjekësore shtetaset V. N., 29 vjeçe dhe E. N., 6 vjeçe, ku kjo e fundit ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore", thuhet në njoftimin e policisë. Drejtuesja e mjetit tip "Benz", 29-vjeçarja Rozina Koleci, e cila shkaktoi tragjedinë me dy të vdekur, u arrestua nga uniformat blu. Nuk dihet ende se çfarë e ka shkaktuar humbjen e kontrollit, ndërsa ende nuk është marrë dëshmia e drejtueses së mjetit për shkak të gjendjes së rënduar në të cilën ndodhet. Ajo pritet të përballet me akuzën "Aksident me pasojë vdekje". Policia shkoi menjëherë në vendngjarje dhe po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të aksidentit. Ndërkohë, dëshmitarët në vendngjarje thanë se ishte drejtuesja e mjetit tip "Benz" që doli nga rruga, duke marrë përpara biçikletën dhe këmbësorët. Pasi doli në korsinë tjetër të rrugës, makina u përplas edhe me një mjet tip furgon. Shoferi i furgonit me të cilin u përplas makina, pasi kishte përplasur fillimisht çiklistin dhe nënën me dy fëmijë, tregon momentet e tmerrit që përjetoi. Ai dëshmon momentin tragjik, kur makina përplasi nënën me 2 vajzat e saj. "Fëmijët ishin në trotuar. Pashë vetëm momentin kur makina i ra gruas me dy fëmijë. Nuk pashë biçikletën. Makina nuk ishte me shpejtësi, ishte normal. Fëmija ishte i vdekur para makinës tonë dhe çiklisti ishte i vdekur pak më tutje. U tmerruam, të shohësh viktima. Ishin pamje të tmerrshme", shpreh drejtuesi i furgonit.



Momenti i aksidentit të djeshëm në Kamëz

**GJOVALIN BUSHI**
Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", drejtori i Spitalit të Traumës, Gjovalin Bushi, shprehet se gjendja shëndetësore e nënës dhe vajzës së mitur është stabilizuar dhe se ndodhen jashtë rrezikut për jetën. "Nëna dhe vajza e mitur ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Janë duke iu nënshtruar disa ekzaminimeve për të bërë disa kontrolle të detajuara", tha drejtori i spitalit, Bushi.

**DËSHMITARI**
"Fëmijët ishin në trotuar. Pashë vetëm momentin kur makina i ra gruas me dy fëmijët. Nuk e pashë biçikletën. Makina nuk ishte me shpejtësi, ishte normal. Fëmija ishte i vdekur para makinës tonë dhe çiklisti ishte i vdekur pak më tutje. U tmerruam, të shohësh viktima. Ishin pamje të tmerrshme", shpreh drejtuesi i furgonit.


United Nations Development Programme

UNDP Empowered lives. Resilient nations.

**TENDER ANNOUNCEMENT**

**Subject: – RFP for Municipal Revenues Planning Assistance**

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked
**UNDP/RFP 48810**
**"RFP for Municipal Revenues Planning Assistance"**

**For more details please refer to the link below:**
**http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/**

**Relevant dates:** All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **5-Sept-18**

**Address for communications:**
Email: **procurement.al@undp.org**
**Or**
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania


## Tiranë, gjyshja gjen pa jetë në vaskë nipin 22-vjeçar




**TIRANE** - Një ngjarje e rëndë ka tronditur ditën e djeshme kryeqytetin. Në orët e para të mëngjesit një 22-vjeçar është gjetur i pajetë brenda banesës së tij. Mësohet se i riu me inicialet J.B. është gjetur nga gjyshja e tij në vaskën e tualetit, fatkeqësisht pa shenja jete. Ngjarja në fjalë ndodhi rreth orës 08:25 në rrugën "Kongresi Manastirit" në Tiranë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se nga hetimet, në trupin e viktimës nuk rezultojnë shenja dhune, ndërkohë që po punohet për zbardhjen e shkaqeve të vdekjes. "Më datë 08.08.2018, rreth orës 08:25, në rrugën 'Kongresi Manastirit', në tualetin e banesës, në vaskë është gjetur pa shenja jete nga gjyshja, shtetasi J. B., rreth 22 vjeç. Nga këqyrjet paraprake nuk rezulton të ketë shenja dhune në trup. Po punohet për zbardhjen e rrethanave dhe përcaktimin e shkaqeve të vdekjes", thuhet në njoftimin e policisë.

Familjarët: Po ndaheshin se kishin konflikte. Agresori i kërcënoi me mesazh para se t'i vriste

KOSOVË

# Tronditet Gjakova, burri ekzekuton ish-bashkëshorten dhe vajzën 9 vjeçe

## *I qëlloi me breshëri kallashnikovi në derë të shtëpisë, policia arreston autorin Pjetër Nreca*

Një krim i dyfishtë brenda familjes ka tronditur Gjakovën mbrëmjen e së martës. Mësohet se Pjetër Nrecaj ka ekzekutuar me breshëri kallashnikovi ish-bashkëshorten e tij 40 vjeçe dhe vajzën e tyre 9-vjeçare në pragun e shtëpisë. Ngjarja e rëndë ku humbi jetën Valbona Marku Nreca dhe e mitura ndodhi në fshatin Brekoc të komunës së Gjakovës, pasi çifti ishte në proces divorci. Siç raportojnë mediat kosovare, viktima dhe autori i dyshuar ishin ndarë, ndërsa nga kjo martesë kishin 6 fëmijë. Po të njëjtat burime thanë se 40-vjeçarja nga Tropoja ishte zhvendosur në Gjakovë pas lufte. Mësohet se shkak i ndarjes së çiftit ishte bërë dhuna që Pjetri ushtronte ndaj Valbonës, ndërsa ajo një ditë kishte vendosur të largohej në shtëpinë e familjes së saj. Ndërkaq, policia e Kosovës ka vënë në pranga autorin e krimit. Pas kryerjes së hetimeve, ka rezultuar se Nrecaj ka shkuar në shtëpinë e ish-bashkëshortes së tij dhe në derën e shtëpisë ka qëlluar për vdekje ish-gruan dhe vajzën e tij.


Viktima Valbona Marku Nrecaj me bashkëshortin


Autori i krimit Pjetër Nrecaj

**HETIMET**

Nënë e bijë do të dalin nga shtëpia me arkivol. Familjarë e miq janë mbledhur për të pritur kufomat e Valbona Marku Nrecaj, 40 vjeçe, si dhe të bijës së saj 9 vjeçe, të cilat u vranë mbrëmjen e së martës.

nga Pjetër Nrecaj. Ky i fundit e vrau ish-gruan dhe vajzën e tij me kallashnikov pas konflikteve të vazhdueshme mes tyre. Familja ka hapur dyert e mortit. Ata kanë rrëfyer për "Express" momentet e ngjarjes së rëndë. "Ish-dhëndri na e vrau vajzën dhe mbesën në pragun e shtëpisë", treguan mes lotësh familjarët. Konfliktet e mëhershme mes çiftit dyshohet të ketë qenë shkaku i vrasjes së dyfishtë që tronditi Gjakovën. Çifti kishte 16 vjet martesë, por pas konflikteve janë ndarë, ndonëse nuk ishin divorcuar ligjërisht. Çifti kishte pesë fëmijë. Tre nga të cilët jetonin me Valbonën e dy të tjerë jetonin me babanë e tyre, Pjetrin.

**FAMILJARËT E VIKTIMAVE**

Nipi i së ndjerës u shpreh se Pjetër Nrecaj kishte shkuar ditën e martë për ta takuar Valbonën me qëllim të rregullimit të raporteve. Por nga aty, Pjetri është larguar për t'u kthyer më vonë me një armë zjarri. Para se të shkonte në shtëpinë e viktimës, i dyshuari i kishte dërguar asaj në telefon një mesazh me përmbajtje kërcënuese. "Tani të pret një dhuratë e bukur ty dhe lalushit do t'i dhembë zemra". Nga familja e së ndjerës thanë se ish-bashkëshorti ushtronte dhunë ndaj saj. "Valbona e ka paditur se ushtronte dhunë ndaj saj dhe u kthye këtu te familja e saj. Ky gjatë ditës dje (që martën) ka qenë te familja. Ka kërkuar të pajtohej. Vajza ka insistuar që nuk do të pajtohet me të. Ky është larguar dhe ka thanë që këtë punë do ta rregullojë siç di vetë", ka thënë nipi i viktimës. Ai sqaroi se pak minuta pas vizitës së parë të Ndrecajt në familjen Marku të Brekocit të Gjakovës, Valbona kishte shkuar në polici për ta raportuar rastin. Policia ka vizituar familjen e së ndjerës, por është larguar nga aty me arsyetimin se nuk e ka gjetur të dyshuarin. "Kur ka ardhur ai më vonë me kallashnikov. E ka njohur terrenin këtu në shtëpi. Edhe nga jashtë ka filluar të gjuajë. Viktimë ranë mbesa jonë me vajzën e saj", thanë familjarët. E ndërkohë, nga Prokuroria Themelore në Gjakovë bëjnë të ditur se ndaj Nrecajt është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh. "Rreth orës 21:00, 43-vjeçari Pjetër Ndrecaj ka shkuar në shtëpinë e familjes së bashkëshortes në lagjen Brekoc të Gjakovës dhe me armën e tipit kallashnikov ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij, Valbona Marku-Nrecaj dhe vajzën e tij nëntëvjeçare K.N.", sqaroi prokuroria.



**MESAZHI I FUNDIT**

Nipi i së ndjerës u shpreh se Pjetër Nrecaj kishte shkuar ditën e martë për ta takuar Valbonën me qëllim të rregullimit të raporteve. Por nga aty Pjetri është larguar për t'u kthyer më vonë me një armë zjarri. Para se të shkonte në shtëpinë e viktimës, i dyshuari i kishte dërguar asaj në telefon një mesazh me përmbajtje kërcënuese. "Tani të pret një dhuratë e bukur ty dhe lalushit do t'i dhembë zemra".

## Policia zbarkon në Berishë të Fushë-Arrëzit, zbulohet kanabis

### Aksion antidrogë në zonën e Lumit të Vlorës, helikopteri zbulon 20 parcela me hashash

**VLORË/PUKË** - Policia vijon aksionet antidrogë në zona të ndryshme të vendit. Dje blutë e Vlorës kanë zbarkuar në terren, ndërsa gjatë kontrolleve ka evidentuar 20 parcela me kanabis. Mësohet se disa parcela me hashash janë evidentuar në fshatrat e zonës së Lumit të Vlorës. Aksioni u shtri në disa fshatra, si Lapardha, Kuçit, Gjorm dhe Treblovë, ku helikopteri ka evidentuar parcelat me kanabis. Policia bën me dije se bëhet fjalë për një kontroll rutinë të përditshëm, lidhur me evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë. Ndërkaq, blutë janë vënë në lëvizje për identifikimin dhe arrestimin e poseduesve të drogës. Po gjatë ditës së djeshme, një sasi e konsiderueshme droge është gjetur në fshatin Berishë të Fushë-Arrëzit. Aksioni në fjalë është shtrirë në njësinë administrative Iballë. Burime për "GSH" thanë se policia ndodhet në terren, në një zonë të thellë malore, ndërsa operacioni po mbahet i fshehtë. Por, sipas dëshmive të banorëve të zonës, mbi 50 forca policie kanë zbarkuar në terren që në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Aktualisht nuk dihet se sa është sasia e drogës së kapur.



## SHKURT

### I dënuar me 6 vjet për drogë, kapet i kërkuari

**GJIROKASTËR** - Policia e Gjirokastrës ka vënë në pranga një të dënuar me 6 vite burg për drogë. I arrestuari është i shumëkërkuari Fatmir Zhupa nga Salaria e Tepelenës. Sipas bluve 42-vjeçari u arrestua rreth orës 15:00 gjatë një operacioni policor në lagjen "18 Shtatori" të këtij qyteti. Zhupa, i cili ishte shpallur në kërkim për veprën penale "Kultivim i bimëve narkotike e kryer në bashkëpunim" u kap në banesën e tij, që e kishte marrë me qira pas shkollës 9-vjeçare "Koto Hoxhi". Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet për veprime të mëtejshme.

### U arrestua për vetëvrasjen e gruas, lirohet polici

**DURRËS** - Lirohet efektivi i policisë së portit të Durrësit, i cili u arrestua dy ditë më parë nën akuzën se shtyu gruan e tij drejt vetëvrasjes. Dje gjykata e qytetit bregdetar vendosi masën e sigurisë "Detyrim paraqitje' për Sherif Hajdarin, i cili u akuzohet për "shkaktim të vetëvrasjes" së ish-bashkëshortes së tij, Merita Hajdari. Ngjarja e rëndë ndodhi të hënën rreth orës 13:20 në lagjen nr. 7 të qytetit bregdetar, gjatë kohës kur në banesë ishte dhe efektivi i policisë. Ndërkohë, pas hetimeve të grupit hetimor, me prova shkencore u vërtetuan se nëna e dy djemve të rritur u vetëvra me një plumb në kokë, me armën e shërbimit të burrit të saj. Efektivi i komisariatit të portit shkoi vet në polici, ku tregoi se gruaja e tij kishte vrarë veten. Më pas u thirrën në polici edhe familjarë të viktimës, të cilët treguan se nga jashtë banese kishin dëgjuar sherrin mes çiftit.

### Helmimi i dasmorëve, në kërkim administratori i lokalit

**ELBASAN** - Një ditë pas mbylljes së aktivitetit të një lokali në Elbasan, pasi aty u helmuan 44 persona gjatë tre dasmave, policia ka shpallur në kërkim administratorin e këtij biznesi. Mësohet se në kërkim është vënë shtetasi me inicialet M.M., (administrator i lokalit "Laguna Blu"), 32 vjeç, banues në lagjen "Brigada 17 Sulmuese". Mësohet se dasmorët, mes të cilëve edhe dy fëmijë, u helmuan fundjavën që shkoi (të shtunën dhe të dielën) ndërsa mbërritën me urgjencë në spital me dhimbje të forta stomaku, të vjella, këputje, diarre dhe dhimbje koke. Dyshimet janë për helmim nga salmonela. Pas inspektimit në lokalin ku ishin mbajtur dasmat, AKU vendosi bllokimin e aktivitetit si dhe gjobë 700.000 lekë. Gjatë inspektimit u sekuestruan produkte ushqimore me bazë mishi e bulmeti, të cilat mbaheshin në kushte të rënda higjieno-sanitare.

Grupi 'NA', Alban Skënderaj dhe Marsela Çibukaj dhurojnë spektakël

# Nata e parë e Festës së Birrës, qyteti i serenatave i tejmbushur nga vizitorët

## *Atmosferë elektrizuese te "Pazari i Vjetër" dhe te sheshi para stadiumit "Skënderbeu"*

**KORÇË**

Ka startuar në qytetin e Korçës, eventi më i madh festiv i vitit, Festa e Birrës, e cila këtë shënon 12 vite suksesi. Ky aktivitet madhështor do të elektrizojë qytetin juglindor për 5 net radhazi. Që në natën e parë, kjo festë ka mbledhur mijëra pjesëmarrës nga të gjitha rrethet e vendit, si dhe jashtë kufijve. Këtë vit organizimi është fantastik dhe me mjaft risi e surpriza. Pesë net të zjarrta me muzikë 'live', nën shijen e të pakrahasueshmes "Birra Korça" do e shndërrojnë Korçën në një qytet magjik dhe qendrën e argëtimit veror për të gjithë Shqipërinë. Edhe në këtë edicion organizatorët e festës janë kujdesur në detaje për të sjellë një program muzikor mjaft të mirë, me emrat më të njohura të muzikës shqiptare dhe jo vetëm, ndërsa hyrja për të gjithë vizitorët vendës e të huaj që do të marrin pjesë në festë do të jetë falas. Festa më e madhe verore në Shqipëri është organizuar në dy pole, tek "Pazari i Vjetër" dhe tek sheshi para stadiumit "Skënderbeu". "Dekori është i veçantë, atmosfera është elektrizuese. Ne po e shijojmë pa fund këtë festë. Po shijojmë dhe të mrekullueshmen 'Birra Korça'", u shprehën disa të rinj nga Tirana. Ndërsa, disa të tjerë të ardhur nga rrethe të tjera të vendit u shprehën se qyteti i Korçës është i gjithi në festë dhe se po shijojnë birrën e tyre të preferuar, "Birra Korça". Atmosfera është nxehur më shumë nga tingujt e muzikës. Mbrëmë performuan grupi 'NA' dhe këngëtarët e njohur, Alban Skënderaj, Marsela Çibukaj, "Urban Band" dhe Zhuli Sheremeni. Stendat ku ofrohej mbrëmë "Birra Korça" kanë qenë të tejmbushura nga shijuesit e saj, të cilët ashtu si edhe vitet e kaluara kanë qëndruar në radhë për të marrë gotat e birrës. Stendat janë të vendosura në disa pika, në mënyrë që konsumatorët të gjejnë atë çfarë kërkojnë. Gjithsej në dy zonat ku zhvillohet festa ndodhen 14 stenda të "Birra Korçës". Organizatorët shpresojnë që pjesëmarrësit në festë gjatë 5 ditëve dhe netëve të saj të arrijnë në 100 mijë, një shifër kjo jo e paarritshme, duke u nisur nga të dhënat e marra nga prenotimet në hotele, bujtina dhe opsionet e tjera akomoduese. Kryesisht vizitorët priten të jenë nga qytete të mëdha të vendit si Tirana, Durrësi, Vlora, Shkodra, Fieri, Elbasani etj. Pritet gjithashtu edhe një numër i lartë turistësh të huaj, pasi festa e "Birrës Korça" i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë. Me një program të zgjedhur muzikor, për të kënaqur preferencat e të gjithëve dhe "Birra Korça", festa jo vetëm do të tërheqë shumë vizitorë të huaj, por nga viti në vit ka promovuar dhe përforcuar imazhin turistik të këtij rajoni.






bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz

### ANNOUNCEMENT

**Private Vocational Training Providers – Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals**

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in the country with the aim to scale-up VET interventions, complementary to the courses offered by public VET providers.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **23 July – 20 August 2018**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer several training courses. The training duration of each course per batch should be at least 1 month.
- The training courses under each contract should target altogether 50-150 young people (19-34 years) in total. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should reflect the following prioritized sectors: ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear and innovative/creative crafts; but are not necessarily limited to these sectors, if justified based on local labour market needs and employment prospects.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- There is no limitation in terms of geographical location, though priority will be given to (rural) locations where public/private vocational training is non-existent or very limited.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 9 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 50,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 400,000 assigned for this activity is allocated.

**Selection Procedure:**

**First step**: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

**Second Step**: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

**Third Step**: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 23 July – 20 August 2018.



bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

**Press Notice**

**To the attention of the general public**

### Make it in Albania – OPENING OF THE SECOND CALL FOR PROPOSALS

Following its mandate from the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and in partnership with the Ministry of Economy and Finance (MoEF), the GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under its third component of Social Participation of Marginalized Youth and Minorities is **opening its Second Call for Proposals from 23 July – 21 August 2018.**

The aim of this call for proposals is to financially support local civil society organizations, to implement small-scale projects that strengthen social empowerment and cohesion, and enable the target group to engage actively, in line with their interests and capabilities, to find common solutions to improve their-, and their respective communities' social and economic situations.

All CSOs registered in Albania with at least 2 years of relevant experience and proven record in youth empowerment and social cohesion are invited to submit proposals under this call for proposals.

The 10 envisaged proposals to be selected through this competitive call shall receive financial support in the amount between 10,000 – 20,000 EUROs (equivalent in ALL).

The proposed interventions submitted by the local CSOs may take different shapes and may include activities that strengthen the interaction between different groups of youth, activities that contribute to the development of life skills, cultural and sports activities, as well as activities that foster the inclusion of minorities, women, persons with disabilities and migration returnees. The long-term outcome of these activities should aim at increasing the target group's social capital and future employability prospects.

In order to submit a proposal for participation in this call, it is necessary to consult the Application Guidelines that may be obtained by it through the ProSEED Facebook page. The Application Guidelines state the defined objectives, and requirements to be complied with and provide detailed information on the procedures for selection. Interested local CSOs can find all the official templates for submitting proposals under this call annexed to these guidelines. Applying CSOs shall submit their applications only electronically to makeitinalbania@giz.de. All applications must be submitted in English language.

For further questions and clarifications on the Application Guidelines, please contact us via email to: makeitinalbania@giz.de during the period **16 – 20 of July 2018**, prior to the opening of the call. After this period GIZ ProSEED shall not answer any enquiry related to the call.

**The deadline for the submission of the proposals is 21 August 2018, 16:00h.**

## Shëndetësi

> Lule basani përmban shumë përbërës fitokimikë. Përbërësit kryesorë janë: derivate të floroglucinolit (0.2-4%) kryesisht hiperforina dhe homologët e saj, naftodiantrone (0.06-04%) kryesisht pseudohipericina dhe hipericina, flavonoide (2-4%) si hiperozidi, rutina etj. **Bima përmban gjithashtu proantocianidina, tanine, vaj eteror (0.1-0.3%), sasi të vogla acidi klorogjenik, aminoacide.**




### Mjeku popullor: Si të përgatisni çajin dhe vajin me këtë bimë. Sa ditë duhet ta përdorni

Voltiza Duro

# YLLI MERJA: Efektet çudibërëse të bimës së basanit në organizëm

## "Ndihmon në kurimin e ulcerës dhe gastritit"

Lule basani është bimë barishtore shumëvjeçare e familjes Hypericaceae (Guttiferae). Në vendin tonë ndeshet e zakonshme në zonat e ulëta. Periudha që mblidhet lule basani është në fund të majit dhe në fillim të qershorit. Bima mund të përdoret e thatë, ose e njomë, por kur është e njomë sasia e bimës që përdoret duhet përgjysmuar, pasi përbërësit kimikë janë më të fuqishëm në bimën e njomë. Basanit mund t'i përdoren majat e lulëzuara e pritet që rrënja e bimës dhe një pjesë e kërcellit që nuk përmban lule të thahen në hije.

**PËRBËRËSIT KIMIKË**

Lule basani përmban shumë përbërës fitokimikë. Përbërësit kryesorë janë: derivate të floroglucinolit (0.2-4%) kryesisht hiperforina dhe homologët e saj, naftodiantrone (0.06-04%) kryesisht pseudohipericina dhe hipericina, flavonoide (2-4%) si hiperozidi, rutina etj. Bima përmban gjithashtu proantocianidina, tanine, vaj eteror (0.1-0.3%), sasi të vogla acidi klorogjenik, aminoacide.

**VETITË E BIMËS**

Lule basani është një bimë çudibërëse, pasi jep efekte në të gjithë organizmin. Ka një përdorim shumë të gjerë e ndikon në sistemin e tretjes, ka efekte qetësuese në organizëm, prandaj ndihmon në ngërçet e stomakut, e në minimizimin e djegieve të stomakut. Kjo bimë ndihmon në shërimin e ulcerës dhe gastritit, prandaj këshillohet të përdoret pothuajse çdo ditë për 45 ditë resht nga individët që vuajnë nga stomaku. Nëse keni djegie apo kthim të ushqimit, bima ndihmon në rregullimin e funksionit të muskujve të stomakut, duke i qetësuar ato, kështu ato mbyllen dhe hapen në kohën e duhur. Por basani ndihmon edhe në rigjenerimin e mukozave të brendshme të organeve, kështu ul inflamacionin e brendshëm. Nëse konsumoni shumë kafe gjatë ditës, e cila rrit inflamacionin e organeve të brendshme dhe rrit gjendjen e hiperaktivizimit, mund të zëvendësoni një kafe me një gotë çaj me lule basani dhe kështu e ndihmoni trupin tuaj të qetësohet dhe të vazhdojë punën normalisht.


Mjeku popullor Ylli Merja

> Basani ndihmon në rregullimin e sekretimit të hormoneve, prandaj edhe ka efekte qetësuese. Kështu ndikon në rregullimin e menstruacioneve, sidomos tek femrat që kanë çrregullime të hormoneve dhe të ciklit.



Bima ndihmon në qetësimin e sistemit nervor e ndikon në qetësimin e ankthit dhe stresit, si dhe prek direkt në sistemin nervor duke e qetësuar atë, pa shkaktuar efekte anësore. Gjithashtu, basani ndihmon në rregullimin e sekretimit të hormoneve, prandaj edhe ka efekte qetësuese. Kështu ndikon në rregullimin e menstruacioneve, sidomos tek femrat që kanë çrregullime të hormoneve dhe të ciklit.

**VAJI I BASANIT**

Lule basani përdoret e plotë ose e copëtuar dhe mund të konsumohet si çaj, por mund të gjejë përdorim edhe vaji i bimës. Doza ditore për të rriturit është 2-4 gram material bimor. Zakonisht, 1 lugë çaji në një gotë me ujë e rekomandohet 1-2 gota në ditë. Ndërsa përgatitja e vajit bëhet kështu: merret lulja e basanit e njomë, copëtohen vetëm lulet e bimës dhe hidhen në një enë qelqi, mbulohen komplet lulet me vaj ulliri dhe lihet përzierja në diell për 45 ditë. Pas 45 ditësh kullohet vaji dhe ruhet në errësirë. Më tej konsumohet 1 lugë gjelle në mëngjes çdo ditë. Për përdorim të jashtëm, vaji i basanit përdoret në trajtimin e plagëve, djegieve, pezmatimeve të lëkurës. Vaji i kësaj luleje është shumë i fuqishëm në mbylljen e plagëve, pasi ndihmon në rigjenerimin e qelizave, e të mukozave të brendshme. Ndërkohë, ky vaj përdoret si përbërës në kremra rigjenerues për plagë si dhe për kurimin e hemorroideve në fund të zorrës së trashë. Kremi kundër hemorroideve ndihmon që të hyjë në thellësi të zorrës, sepse përthithet shumë shpejt si dhe lubrifikon e mbyll plagët e brendshme në zorrë. Duhet të bëni shumë kujdes, pasi kur vaji i lule basanit përdoret për lyerje të lëkurës nuk duhet të ekspozoheni në dritën intensive të diellit, pasi mund t'iu formohen njolla kafe në trup.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë **06 shtator 2018** nga **ora.08.00-ora.16.00** tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandi i I-rë, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq 1, ZK 8603, me cmim fillestar **4725000 lek**; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me çmim fillestar **35938000 lek.**

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN " shpk (NUIS J97201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: **052226000** ose cel: **0692075 644**

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine:**

*Truall+Ndertese e rregjistruar ne rregjistrimin hipotekore me nr pasurie 9/268 ne ZK nr 8592, me nr prone 47 , me siperfaqe totale 161 $m^2$ , nga kjo 66 $m^2$ ndertese me adrese l partizani ne Shkoder*

*2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren **2,016,000 ( Dymilione e gjashtembedhjetemije ) Lekë.***

*Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date **15.08.2018** ora **16:16** ne Zyren e permbaruesit gjyqesore **Genti Bushati** me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.*

VERA, DIELLI, DETI DHE SYTË TUAJ

SUMMER pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E enjte 9 Gusht 2018



## E akuzojnë se përdor fotoshop, Aurela Hoxha befason me përgjigjen



## Armina Mevlani "çmend" rusët dhe amerikanët

BULEVARDI POLITIK



- Kërcënimi, Haradinaj batuta me gazetarët: Po i ruaj unë policët
- Me muzikë klasike në sfond, si po relaksohet kryeministri Rama
- Jul Deda, i shqetësuar: Fjalët e Bashës kur përzihen me rigon...
- Ish-deputetja, Qosjes: Mjeshtër i regjur në sallonet e Beogradit



Rrëfehet balerina: Jeta ime mes baletit dhe biznesit, pushimet jashtë

# ISIDA MOLLAYMERI: Ju tregoj për rivalitetin që ka mes kolegëve

*"Jam e përkëdhelura e Zotit, kam shumë miq"*

## Rrëfehet balerina: Jeta ime mes baletit dhe biznesit, pushimet jashtë

# Isida Mollaymeri:

## Ju tregoj për rivalitetin që ka mes kolegëve

### *"Jam e përkëdhelura e Zotit, kam shumë miq"*




Egla Xhemali

*Ajo është një nga balerinat më të dashura për publikun. Bukuroshja ka rrëmbyer zemrat e teleshikuesve me performancat dhe energjinë pozitive që përcjell. Isida Mollaymeri vjen në një rrëfim krejt ndryshe për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta Shqiptare", për të ndarë me ne vështirësitë e të qenit balerinë, aventurat, rivalitetet mes kolegëve, për natyrën e saj, pushimet si dhe projektet më të afërta. Sipas saj, bota e artit në përgjithësi të fal më së shumti kënaqësi shpirtërore se sa të mira materiale. Për të është shumë e shtrenjtë mbështetja e publikut, pasi ata e motivojnë. Isida na tregon për fobitë që ka ndaj lartësive dhe pasionin për udhëtimet. Balerina pohon se mes kolegëve ka rivalitete, po asaj nuk i ka interesuar kurrë kjo gjë. Është e rëndësishme që luftën ta kesh me veten, pasi ajo të shtyn që të punosh fort dhe të ecësh përpara. Mollaymeri thotë se e thërrasin çafkë, ngaqë është mjaft kërkuese në punë. Ajo është e përkëdhelura e të gjithëve si në familje, ashtu edhe nga miqtë. Balerina deri më tani nuk ka pasur kohë mjaftueshëm për pushime, por shumë shpejt do udhëtojë drejt Turqisë dhe Spanjës. E pyetur për projektet më të afërta dhe surprizat që do sjellë për publikun, Isida thotë se impenjimet fillojnë në shtator dhe se i është përkushtuar totalisht biznesit që sapo ka hapur.*

**A po fiton terren baleti në Shqipëri?**

Terren nuk mund të them, sepse edhe në shfaqe janë po të njëjtit njerëz që vijnë. Është po i njëjti publik le të themi, që vjen e shikon shfaqjet. Mua më vjen mirë se gjithmonë shfaqjet e baletit janë plot dhe kjo është një gjë për t'u uruar. Do kisha shumë dëshirë që pjesa më e madhe e publikut të ishin të rinj, megjithëse nuk është të kështu. Nuk është se të rinjtë janë kaq shumë artdashës. Nuk shoh nga ana e tyre një dëshirë për të ardhur për të parë balet, opera apo qoftë edhe teatër. Unë shkoj të ndjek teatër edhe vetë dhe e shoh që nuk është se ka të rinj, po më shumë grupmosha nga 30 e sipër, por që është mirë. Mua më vjen mirë se nuk mund të kërcej pa publik. Me të mund të japësh e të marrësh, pasi po nuk pate diçka ku të marrësh, ti nuk përcjell dot asnjë emocion.



**Ku qëndron vështirësia e të qenit balerinë?**

E para ekonomikisht është një gjë që nuk kënaqesh kurrë. Po të krahasosh nivelin e ekonomisë me nivelin e kënaqësisë që të jep arti janë dita dhe nata. Niveli ekonomik është zero, ndërkohë që kënaqësia që ti ke kur je në skenë është 100%. I bie që gjithmonë të zgjedhësh e ne zgjedhim kënaqësinë. Unë do të doja që të vlerësohej pak më shumë arti në Shqipëri.

**Si ia bën që je kaq në formë?**

Përveç se i gjej gjithmonë vetes punë, përtej baletit jam gjithë kohën me angazhime. Më në fund pas kaq vitesh që doja të hapja një biznes timin, e hapa. Shkoj në palestër sigurisht, angazhimet e tjera, "Dancing with the stars" dhe shfaqjet private. Jam gjithë kohën në lëvizje, kështu që kjo më mban në formë, pa harruar dhe ushqimin. Unë ha çdo gjë dhe ha rregullisht. Nuk ha jashtë, nuk ha keq, ha ëmbëlsira, akullore pafund. Mund të them që kam dhe luksin që nuk shëndoshem. Ndoshta e kam metabolizmin e tillë.

**Cili është ai moment që do e konsideroje si më të vështirin në skenë?**

Në skenë nuk mund të them, pasi atje ndihem më rehat se në prova. Këtë ma ka pas thënë edhe Agron Aliaj, që jam shumë ndryshe në prova në krahasim me skenën. Nuk dua t'ia di kush është rreth e rrotull kur jam në skenë. E shijoj pafund. Jam vetvetja e prandaj arrij të përcjell 100% atë që dua të jap. Bota fillon e mbaron aty në momentin kur unë performoj në skenë. Më thonë të gjithë që edhe kur kërcej në trupë dallohem dhe kjo është një gjë shumë e mirë.

**Nëse do e ktheje kohën pas, çfarë do kishe dashur të ndryshoje?**

Nëse do e ktheja kohën pas do kisha



# E akuzojnë se përdor fotoshop, Aurela Hoxha befason me përgjigjen

Aurela Hoxha është një nga modelet më të dashura në Shqipëri. Kjo nuk i ndalon fansat që ta kritikojnë atë se përdor fotoshop në fotot e saj. Bukuroshja ka qenë mjaft aktive në rrjetet sociale këto ditë të nxehta, ku nuk kanë munguar postimet anekënd vendeve që ka vizituar. Së fundmi, në një prej fotove që ka hedhur në "Instagram", ajo ka bërë që fansat të reagojnë. Sipas një ndjekëseje, modelja i ka zgjatur këmbët, pasi në realitet nuk i ka kaq të gjata. Modelja i ka kthyer përgjigje ndjekëses, duke i hedhur poshtë aludimet se përdor fotoshop.






# Armina Mevlani "çmend" rusët dhe amerikanët

Blogerja Armina Mevlani në pjesën më të madhe të rasteve i shoqëron postimet e saj të shkruara në anglisht. Kjo për arsye se fansat e saj janë nga çdo cep i botës. Për të hequr dyshimet e të gjithëve, ajo ka treguar një statistikë të profilit të saj. Duket se pjesa më e madhe e ndjekësve të bukuroshes shqiptare janë amerikanë, rusë, meksikanë dhe kolumbianë. Ndjekësit nga Shqipëria janë në të njëjtë përqindje me ata rusë. Do të habiteni, por ja që qenka e vërtetë.








dashur që prindërit e mi të kishin qenë më të pasur, që të bëja shkollën në Angli. Kur kam qenë në vit të katërt kam fituar një konkurs, që mund të vazhdoja shkollën jashtë. Shkolla e baletit ishte shumë e shtrenjtë në Londër edhe prindërit e mi nuk kishin mundësi ta paguanin.

**Cili kërcim të përfaqëson më tepër?**
Unë jap maksimumin tek të gjitha kërcimet. Baletin klasik e dua fort, kontemporani më pëlqen, karakteret po ashtu. Mund të them që kërcimi që e ndjej më shumë veten është ai klasik. Në teatër ndihem shumë mirë gjithmonë.

**Të pëlqejnë aventurat? Do cilësoje ndonjë si të rrezikshme?**
Unë përfshihem shumë në aventura, po s'e di nëse do quheshin të rrezikshme apo jo. Aventurat quhen të bukura se janë të papritura dhe ajo që ndodh është e çuditshme. Si të rrezikshme mund të quaj ngjitjen në Pilul. Unë i kam pak si fobi lartësitë, kam problem edhe kur nuk jam vetë në timon.

**A ka rivalitete mes balerinëve?**
Oh, ka shumë rivalitet. (qesh) Ka rivalitet në mënyrë që njerëzve të zakonshëm nuk u shkon mendja. Unë s'jam marrë kurrë me këtë pjesë, se nuk më ka interesuar dhe më vjen shumë për të qeshur. Mendoj se secili nga njerëzit ka fatin dhe kismetin e vet. Për mua janë bërë gjithmonë njerëzit xhelozë. Edhe mikeshat e mia, që unë i kam menduar se i kam mikesha të vërteta kanë shfaqur xhelozi. Mua më ka ardhur keq për këtë gjë. Nuk mendoj se rivaliteti e ushqen njeriun, domethënë rivaliteti duhet të jetë brenda teje për llogarinë që ke ndaj vetes, nuk duhet të jetë karshi personit përballë. Në mos Isida, do jetë dikush tjetër, gjithmonë do ketë një person përballë që mund të jetë më i mirë se ty. Mund të jetë edhe më i keq, por mund të ketë mik. Ç'rëndësi ka kjo gjëja. Do jetë një hap para teje gjithsesi. Unë mendoj që secili duhet të shohë mirë atë që bën vetë, pa parë të tjerët. Këtë që sapo thashë, unë e kam si ligj te vetja, ndaj jam personi më pak xheloz në jetë.

**Çfarë natyre ka Isida?**
Isidës i thonë të gjithë çafkë. Jam shumë çafkë në fakt. Kam shumë kërkesë llogarie në punë, kur udhëheq vetë jam bishë. Ata që më njohin vërtetë dhe miqtë e miqtë e mi që janë jashtë punës sime thonë që unë jam njeri shumë i brishtë. Jam tjetër gjë e asaj çafkës që tregoj në punë. Në art është si në xhungël. Ose duhet të hash, ose duhet të të hanë. Kështu që duhet të jesh i gjallë. Nuk është se kam pasur prindërit artistë apo të kem pasur ndonjë mbështetje. Unë kam qenë gjithmonë vetëm, kështu që më është dashur të luftoj për gjërat dhe të drejtat e mia. Kjo ndoshta më ka bërë të jem pak çafkë dhe e zonja e vetes, po jam tip shumë i gjallë. Të gjithë më thonë se jam "ON". Jam e qetë vetëm kur jam me pushime, me miqtë, por në punë jo.

**Si e organizon një ditë të zakonshme?**
Si e organizoj s'e di, por gjithmonë më del gjithë dita e zënë. Jam gjithë kohën në punë. Pas pune i gjej vetes edhe një punë tjetër. (qesh) Më pas më del ndonjë kinema ose teatër, ose duhet të po ndonjë kafe me ndonjë shoqe. Shpesh shkoj në Durrës për të parë perëndimin, kështu që varet nga dita. Natyrën e kam shumë qejf, udhëtoj shumë. I adhuroj udhëtimet, për mua janë kënaqësia më e madhe që mund të ketë njeriu. Harxhoj shumë lekë për të udhëtuar. Mendoj që mëson shumë, shikon gjëra ndryshe.

**Sa është e përkëdhelur Isida?**
Jam shumë e përkëdhelur. Në fakt, më kanë përkëdhelur të gjithë. E gjithë shoqëria më thërret princeshë, sa edhe në punë kur duan të më nervozojnë më thotë "Ti je mësuar like a princess". Në shtëpi jam shumë e përkëdhelur. Unë mund të gatuaj, ose mund të bëj punë vetëm në verë, kur është Bajram ose kur është viti i ri. Çdo gjë ma bëjnë prindërit, madje edhe në mëngjes më zgjon babi me shumë dashuri, kështu që jam e përkëdhelur nga të gjitha anët. Mendoj se jam e përkëdhelur nga Zoti dhe e falënderoj shumë atë për këtë.

**Je vajza që u tregon gjithçka familjarëve apo nuk flet me ta?**
Mamit dhe babit i tregoj shumë pak. Nuk dua t'i shqetësoj. Ata dinë 1% të gjithë problemeve që unë kam hasur. Në familje tregoj vetëm gjërat e qejfit.

**Cili është përkufizimi që do i jepje lumturisë?**
Mendoj që njeriu duhet të njohë veten që të jetë i lumtur. Nëse njeriu e njeh veten dhe e pranon ashtu siç është, atëherë është i lumtur.

**Sa miq ka Isida? Je selektive apo përshtatesh me këdo?**
Kam shumë miq, por edhe përshtatem me këdo. E kam thënë gjithmonë dhe e rithem që Zoti është treguar shumë bujar me mua, pasi në jetë time më ka lënë vetëm njerëzit e mirë. Jo se i kam unë pranë vetes dhe janë njerëz të mirë, por sepse njerëzit e mirë e tregojnë veten në ditë të vështira. Sa herë që kam pasur ditë të vështira në jetën time, të gjithë miqtë që kam rreth e rrotull kanë qenë pranë meje. Ata që nuk kanë qenë pranë meje, nuk janë më në jetën time.

**I ke planifikuar pushimet për këtë verë? Ku do pushosh?**
Me atë po merrem. (qesh) Të them të drejtën nuk kam pasur kohë që të merrem me pushimet. Ndoshta në Spanjë, nuk e di akoma, nuk e kam vendosur. Dua të iki tri ditë tek Almeda, te shoqja ime në Turqi dhe më pas them të iki në Spanjë.

**Cilat janë projektet e tua më të afërta? Me çfarë do na surprizojë Isida?**
Kam një projekt në shtator. Projekti më i ri është biznesi që sapo kam hapur, linja e produkteve "Vagheggi". Tani është vetëm për femrat, më vonë do jetë edhe për meshkujt. Pastaj është pjesa e teatrit, kalendari është i ngjeshur si gjithmonë.

Verën e duam për shkak të diellit, detit, plazhit, pushimit veror… Mirëpo, dielli edhe deti duhet të kuptohen seriozisht, sepse në të kundërtën do të mund të kemi probleme serioze me sytë





# Vera, dielli, deti dhe sytë tuaj



Thonë që sytë janë pasqyrë e shpirtit dhe shqisa më e rëndësishme. Megjithatë, me secilën dalje në ambient të hapur i rrezikojnë goxha shumë. Asnjëherë nuk duhet harruar se syri është organi më i ndjeshëm ndaj dritës së diellit dhe ekspozimet e gjata ndaj rrezeve ultraviolet mund të shkaktojnë plakjen e syrit dhe dëmtimin e shikimit. Pasojat mund të jenë edhe më të rënda, që nga një sërë patologjish si katarakti apo shkatërrimi i retinës së syrit, deri në humbjen e shikimit.
Mos harroni të mbani syze dielli në plazh. Ky është rregulli numër një. Por syzet të jenë të një cilësie të mirë, ndryshe nuk kanë vlerë. Kujdes më të madh duhet të tregojnë moshat e thyera dhe fëmijët, por kjo nuk do të thotë që të rinjtë, që shpesh janë edhe më indiferentë, të neglizhojnë mbajtjen e syzeve të diellit.
Mbrojtja që i bën syri vetes nuk është e njëjtë për të gjithë njerëzit, pasi sytë dhe karakteristikat e syve ndryshojnë sipas tipareve të secilit, ku në këtë rast vlen ngjyra e syve. Kështu, një person me lëkurë me ngjyrë të hapur ka më pak pigment të iridës së syrit, ndaj është më i ndjeshëm.
Pra, sa më e errët të jetë ngjyra e bebes së syrit, aq më e vogël është sasia e dritës së diellit që depërton syri. Ndërkohë, që krahas tyre këshillohet të mbahet edhe një kapele me strehë të gjerë.
Nuk duhet të tregoheni indiferent ndaj diellit kur jeni buzëdetit ende, nëse nuk e ndieni se ai ju djeg. Prania e nxehtësisë është e përhapur në mënyrë të njëtrajtshme, edhe pse freskia e detit na krijon një iluzion, që na bën që të mos shqetësohemi shumë për rrezet dhe dëmin që kanë ato për lëkurën, sidomos të fytyrës.
Rreziku i rrezatimit nga dielli është i pranishëm edhe nëse qëndroni në hijen e çadrës. Ndërkohë që në këtë periudhë, rrezet ultra të kuqe kanë epërsi më të madhe për të goditur zonat e djegura në trup, me qëllim krijimin më pas të infeksioneve apo tumoreve të lëkurës. Veprimi i rrezeve diellore mund të thajë lëkurën e ndjeshme, ndaj të gjithë personat që kanë këtë tip lëkure, duhet të tregojnë kujdes dhe të ndjekin disa rregulla të thjeshta.

# Kërcënimi, Haradinaj batuta me gazetarët: Po i ruaj unë policët



Një ditë pas publikimit të lajmit se kryeministri i Kosovës është kërcënuar dhe për këtë arsye ka shtim të forcave të sigurisë që e ruajnë, Ramush Haradinaj i është përgjigjur interesit të gazetarëve për këtë çështje. Por me sa duket, kryeministri kosovar e ka marrë me sportivitet këtë problem. Gjatë konferencës së fundit me mediat, Haradinaj bëri batuta me gazetarët, të cilët i bëri të qeshin. Pyetjes së a e ndjen veten të rrezikuar, Haradinaj iu përgjigj se "ai po i ruan policët". "Për kërcënimin, po, unë po i ruaj do policë, i kam bukur do, mirë jam kah i ruaj. Unë jam kah i mbroj mirë, rehat janë. Për besë jam kah i ruaj mirë, nuk janë ankuar diçka. Ju siguroj që të sigurt janë, edhe unë jam i sigurt", ka thënë Haradinaj me shaka.

# Me muzikë klasike në sfond, si po relaksohet kryeministri Rama

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama postoi dje një video në "Instagram", ku në sfond dëgjohet muzikë klasike. Në videon e postuar prej tij, Rama nuk ka zgjedhur të shkruajë asnjë përshkrim, duke lënë të kuptohet se po relaksohet me muzikë. Rama njihet si një ndër politikanët më aktivë në rrjetet sociale, ku së fundmi i preferuari i tij është bërë "Instagram"-i me opsionet e tij.






# Jul Deda, i shqetësuar: Fjalët e Bashës kur përzihen me rigon...

Aktori Julian Deda, që është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike, ka sulmuar kreun e kësaj partie, Lulzim Basha. Sipas tij, pavarësisht fjalëve, Basha i tradhtoi njerëzit edhe për çështjen e Teatrit Kombëtar. Ai thotë se Basha nuk duhet besuar më. Aktori i njohur sjell në vëmendje deklaratat e Bashës të tipit se 'pa shkelur mbi trupin tim nuk bëhet...', ndërsa në finale ato për të cilat Basha është zotuar se nuk do bëhen, janë bërë. "Nëse dikush ju thotë 'pa shkelur mbi trupin tim nuk bëhet', mos i besoni, dijeni se e ka kot. Ka kohë që nuk funksionon si shprehje. Në politike ka dështuar disa herë, madje as për çështjen e Teatrit s'nuk. Me pak fjalë është thjesht po... me rigon".



# Ish-deputetja, Qosjes: Mjeshtër i regjur në sallonet e Beogradit



Ish-deputetja e LDK-së, Melihate Tërmkolli, iu kundërpërgjigj Rexhep Qosjes, i cili mbështeti idenë e shkëmbimit të territoreve. "Akademiku, me këtë logjikë, na thotë se edhe Lugina edhe Veriu qenkan të Serbisë, prandaj hajt ta mashtrojmë pak Serbinë e ia marrim bile Luginën. Po pra! Rrjedhimisht akademiku Qosja na thotë se Serbia paska pasur të drejtë që ka bërë gjenocid kundër shqiptarëve, se lufta e saj kundër shqiptarëve e Kosovës paska qenë legjitime siç na qenka legjitime e drejta për Veriun e Kosovës", shkruan Tërmkolli. "Mjeshtri i regjur në sallonet e Beogradit, prandaj provon të na akuzojë se nëse nuk e pranojmë idenë e tij dhe dishepullit të tij atëherë del se 'kundërshtarët e shkëmbimit të territorit, po ia dhurojnë Serbisë edhe Luginën edhe Veriun' dhe si 'baba' i mirë, ai do të dëshmojë nesër para historisë dhe të na thotë troç, se ja pra 'nuk deshët ta jepni veriun, e humbët edhe Luginën edhe Veriun'", shprehet Tërmkolli.

DOSSIER
BIRRA KORÇA

Ekskluzive/ Zbulohet korrespodenca sekrete e vitit 1963 e udhëheqjes së lartë për "Birra Korça" mes Mehmet Shehut, Kolekës, Toskës, Ngjelës, Theodhosit, Spahiut, Murrës etj.

# Kur Enver Hoxha e Byroja "ngriheshin në këmbë" për cilësinë e standardet e "Birra Korça"

*Drejtori Sotir Tushi: Shoku kryeministër, të zgjerojmë kapacitetet prodhuese, se ka shumë kërkesa për birrën tonë*

Nga Dashnor Kaloçi

Festa tradicionale e "Birrës Korça", që ka filluar mbrëmë në qytetin e Korçës dhe që zhvillohet për të disatin vit me radhë, ka mbledhur me mijëra e mijëra adhurues të kësaj "pije magjike" jo vetëm nga ai qytet ku dhe është prodhuar ajo për herë të parë në vitin 1928, por edhe nga qytete të tjera, pa harruar këtu dhe me qindra turistë të huaj që kanë nisur ta frekuentojnë atë festë prej disa vitesh. Por duhet thënë dhe pranuar se "ustallarët" kryesorë të asaj "pijeje simbol" mbeten korçarët, gjë të cilën pjesa më e madhe e kanë "zanat" dhe të trashëguar edhe nga të parët e tyre, që e kanë shijuar atë për dekada me radhë. Jo më kot prej tyre, pra prej "ustallarëve" korçarë, ka mbetur shprehja e famshme proverbiale "për një birrë Korçe rron njeriu", që ata e përdorin me mjaft kënaqësi jo vetëm ditët e festës. Por po kështu, pakkush prej tyre dhe aq më pak nga "jabanxhinjtë" që frekuentojnë atë festë kanë njohuri për historinë e fabrikës që e prodhon atë që nga koha e Mbretërisë së Zogut, i cili ishte dhe "nuni" që firmosi dhe dha aprovimin për ndërtimin dhe prodhimin e saj. Ndër të paktat fabrika që trashëgoi regjimi komunist nga periudha e Monarkisë, jo vetëm që nuk e mbylli atë (siç veproi tek-tuk me disa fabrika apo punishte të tjera të ndërtuara në atë periudhë), por pas shtetëzimit të saj në vitin 1945 e në vazhdim, u kujdes që ta mirëmbante dhe ta zgjeronte atë. Madje jo vetëm kaq, por për çështjen "Birra Korça" janë marrë seriozisht krerët më të lartë të regjimit komunist të Enver Hoxhës, duke filluar nga kryeministri i kohës, Mehmet Shehu; zv.kryeministrat Spiro Koleka e Koço Theodhosi, anëtarë të Byrosë Politike si Haki Toska e Prokop Murra, apo dhe ministra si Kiço Ngjela e Xhafer Spahiu etj., funksionarë dhe zyrtarë të lartë të asaj kohe. Veç të tjerash, kjo bëhet e ditur edhe nga një numër dokumentesh arkivore, që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit (Fondi 14. struktura, aparati i Komitetit Qendror i PPSH-së), të cilat po i publikojmë të plota në këtë shkrim ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare". Me mjaft interes në këto dokumente është dhe raport-informacioni i drejtorit të Ndërmarrjes Shtetërore Industriale "Birra Korça", Sotir Tushi, i cili në vitin 1963 i kërkonte kryeministrit Mehmet Shehu që të bëhej i mundur zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të fabrikës që ai drejtonte, si rezultat i kërkesave dhe nevojave të mëdha që kishte tregu për atë asortiment. Apo këmbëngulja e zv.kryeministrit "kursimtar" Spiro Koleka, i cili nuk jepte aprovimin që tapat e birrave të mos përdoreshin më shumë se një herë. Por të gjitha këto tashmë i përkasin historisë dhe për të cilat "ustallarët" korçarë me të drejtë "as që duan të dinë bre byrazer", pasi nga mbrëmë ata janë mbledhur e po e shijojnë me mjaft kënaqësi atë "pije magjike" në lokalet dhe sheshet e qytetit të tyre.

**REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE**

**MINISTRIA E TREGTISE MINISTRIA E INDUSTRISE**
(Dega e Ushqimit Social) (Drejt. e Indistr. Ushqimore)
**Nr. 98/198 Prot. Nr. 16/48 Prot.**

**Tiranë, më 4.5 1963**
**Lënda** "Mbi tapat korona të shisheve të birrës dhe pijeve freskuese"

SHOKUT SPIRO KOLEKA
**ZV.KRYETAR I K.M.R.P.SH.**

SHOKUT KOÇO DHEODHOSI,
**PRESIDENT I KOMISIONIT TE PLANIT TE SHTETIT**
**Për njoftim:**
SHOKUT HAKI TOSKA
**SEKRETAR I KOMITETIT QENDROR TE P.PSH.**
**TIRANE**

Duke qenë para një problemi shumë preokupant, gjatë vit 1962 në zbatim të shkresës Nr.11/148 datë 22.VII.1962 të Kryeministrisë "mbi grumbullimin dhe përpunimin e tapave korona të shisheve të birrës dhe pijeve freskuese", nga organet e tregtisë, për disa herë është kërkuar për t'u rishikuar urdhri i mësipërm.

Gjatë vitit 1962 nga ana jonë u muarrën të gjitha masat për të zbatuar drejt urdhrin dhe në fakt ku gjeti zbatim të plotë, me gjithë telashet që u hasën si nga ana e ndërmarrjeve tregtare, ashtu edhe nga ana e ndërmarrjeve të industrisë, por praktika tregoi se zbatimi i këtij urdhri, me gjithë anët pozitive për kursimin e teneqesë si material deficitar importi, ka shumë anë negative sikurse do të shpjegohen më poshtë, të cilat janë më të shumta nga anët pozitive dhe anulimi i zbatimit të tij të bëhet i domosdoshëm.

**1.** Duke përdorur më shumë se një herë tapat korona dhe sugero në shishet e birrës dhe pijeve freskuese është dëmtuar rëndë cilësia e prodhimit për faktin se nuk bëhet mbyllja hermetike, për pasojë del gazi, i cili bën të dobësohet cilësia nga njëra anë dhe nga ana tjetër fermentohet birra, e cila humbet të gjitha karakteristikat e saj dhe kthehet në uthull, duke humbur kështu birrën e cila koston 13.61 lekë dhe lupulon si lëndë e parë që importohet, me vleftë 1.55 lekë, për të fituar një tapë, e cila koston vetëm 0.92 lekë.

Pra, sikurse shihet edhe si material importi nuk fitojmë asgjë, sepse në qoftë se fitojmë tapën, humbasim lupulon që është përsëri mall importi, përveçse lëndët e tjera që përbëjnë birrën.

Nga ripërdorimi i tapave korona dhe atyre sugero nuk ka ndërmarrje tregtare që të mos ketë sasira të konsiderueshme birre të prishur, përveçse sasive që i janë kthyer industrisë, e cila i ka përpunuar në uthull, duke shpenzuar përsëri.

**2.** Duke ripërdorur tapat korona, në çdo parti birre të furnizuar, një numër i konsiderueshëm shishesh dalin pa gaz, ose të fermentuara të cilat iu serviren klientëve. Një gjë e tillë ka bërë që nga njëra anë të mos flitet mirë për birrën, duke i vënë asaj një nam të keq dhe nga ana tjetër të krijohet në konsumatorët dyshimi dhe pra, të konsumohet birrë më pak. Ne mendojmë se edhe kjo ndikon negativisht në anën ekonomike për faktin se shitet më pak birrë dhe për pasojë, humbasim të ardhurat që siguron jo vetëm kjo, por edhe artikujt e tjerë që shiten bashkë me birrën.

**3.** Përveç këtyre, Kombinati Ushqimor "Ali Kelmendi" në Tiranë, me shkresën e tij Nr.1/172 datë 24.XI.1962 ngre me të drejtë edhe disa anë të tjera negative, të cilat ndikojnë si në anën ekonomike, ashtu edhe në drejtim të shëndetit të konsumatorëve sikurse janë:

a) Rendimenti i repartit (duke përdorur tapat korona), ulet në 20-25%.

b) Me gjithë dezinfektimin dhe sterilizimin e tapave të ripërdorura, përsëri, higjienikisht dyshohet për sterilizimin e tyre, mbasi në sipërfaqe dhe në brendi krijohen fole mikrobesh.

c) Për zgjatjen e afatit të rezistencës së birrës, kjo sterilizohet, por duke ripërdorur tapat; një pjesë e mirë e kësaj pune dështon, sepse tapat nuk sigurojnë një mbyllje hermetike. Në disa raste ato rrjedhin çurk, sidomos mbas lëvizjeve të shumta që pëson malli gjatë transportimit.



d) Nga kontrollet në repartet e fabrikës, një pjesë e mirë e pijeve freskuese rikthehen në kantinë, gjë që sjell ngritje të theksuar të kostos dhe uljen e cilësisë.

Duke marrë parasysh gjithë këto anë negative, ne mendojmë se urdhri i më sipër duhet të anulohet dhe tapat korona të përdoren vetëm njëherë.

Në rast se pranohet ky propozim, atëherë Komisioni i Planit të Shtetit të sigurojë Ministrinë e Industrisë mbi kontingjentin e planifikuara për vitin 1963 dhe 36 tonë teneqe për prodhimin e 14.400.000 copë tapa korona si dhe 3 milionë tapa sugero.

Për sa më sipër është dakord edhe Ministria e Shëndetësisë dhe Bashkimi Qendror i Koop. Konsumit.

Rilutemi edhe njëherë që për problemin në objekt të jepen urdhra të shpejta.

**MINISTRI I INDUSTRISE MINISTRI I TREGTISE**
**(XHAFERR SPAHIU) (KIÇO NGJELA)**

....................................................................

**Shënim.**
Lidhur me kërkesën që bën Ministria e In-



Në brendësi të ambienteve të fabrikës së 'Birra Korça'



Godina e fabrikës së 'Birra Korça'



Enver Hoxha së bashku me Nexhmije Hoxhën duke konsumuar 'Birra Korça' në darkat e tyre

dustrisë së bashku me Ministrinë e Tregtisë për mospërdorimin më shumë se një herë të tapave korona për shishet e birrës, ne biseduam me shokët e Kryeministrisë (me shokun Hysen Bukali) dhe rezulton se shoku Spiro Koleka nuk është dakord që ato të mos përdoren më shumë se njëherë. Ai është i mendimit dhe do të nxjerrë një urdhër që të caktohet një komision me shokë nga Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Kryeministria për të verifikuar në vend, për një periudhë prej një muaji të gjitha anët negative që shënohen në relacionin e përbashkët të dy ministrive dhe mandej të vendoset definitivisht për këtë problem.

**DREJTORI I DREJTORISE INDUSTRI-NDERTIM**
(Prokop Murra)
**Tiranë më 23.II.1963**

.................................................................................

**Shënim**

Shokët e Kryeministrisë e kanë parë këtë problem dhe kanë arritur në konkluzionin se tapat e birrës mund të përdoren deri në dy herë. Por kjo ka vështirësi, sepse duhen seleksionuar ato që janë përdorur një herë dhe ato që janë përdorur mbi dy herë. Prandaj shokët e Kryeministrisë janë duke parë mundësitë e përdorimit të tapave të shisheve të birrës në ndonjë punë tjetër, si p.sh. në prodhimin e mesurave për Kombinatin e Tekstileve "Stalin", etj.

8.5.63 (Firma)

.................................................................................

**REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE**
**N.I.SH. BIRRA KORÇE**
NR. 520 SEKRET **KORÇË**
**12.IX.1963**

**Landa**: "Mbi prodhimin dhe shpërndarjen e birrës"

**KRYETARIT TE K.MINISTRAVE TE R.P.SHQIPERISE**
**Shokut MEHEMT SHEHU**
**SEKRETARIT TE KOMITETIT QENDROR P.P.SHQIPERISE**
**Shokut Haki Toska**
**MINISTRIT TE INDUSTRISE**
**Shokut XHAFER SPAHIU**

**TIRANE**

Për pesëvjeçarin e III plani i birrës për fabrikën tonë është caktuar nga 45.000 Hl. për çdo vit. Por si në vitin 1961, po ashtu edhe në vitin 1962, plani i prodhimit në këtë fabrikë nuk është plotësuar. Edhe për dhjetëmujorin e vitit në vazhdim kemi krijuar një deficit prej 1.451 Hl. birrë.

Kapaciteti normal i fabrikës birrës varet kryesisht nga reparti i zierjes. Për konditat e fabrikës sonë, duke zbritur kohën e revizionimit të makinerisë së këtij reparti dhe kohën e nevojshme për shërbimet profilaktike të kaldajës së avullit dhe të vetë agregateve të zierjes, kapaciteti nominal i këtij reparti arrin deri në 46.450 Hl. Kjo sasi llogaritet për 683 zierje që duhet të bëhen normalisht gjatë gjithë vitit. Për një shfrytëzim normal të këtij kapaciteti dhe për realizimin ritmik të planit prodhimit duke iu përgjigjur plotësisht standardit shtetëror të stazhionimit të birrës, duhet të prodhojmë çdo muaj rreth 3.90 Hl. birrë.

Praktika e deritanishme ka treguar se në planet tona, prodhimi i birrës për treg nuk është përputhar asnjëherë me kapacitetin dhe realizimin ritmit të planit, por nga një tremujor në tjetrin ka pasur ndryshime. Kjo ka ardhur nga nevojat e tregut, e cila në tremujorin e parë dhe të katërt, kërkesat i ka pasur shumë të vogla në krahasim me tremujorët e dytë dhe të tretë. Kështu p.sh., ndërsa në tremujorin e parë të vitit në vazhdim, kapaciteti i zierjeve ka qenë 12.600 hl, në fakt janë prodhuar për shitje 5.930 hl. Pra, kapaciteti në këtë rast është shfrytëzuar vetëm rreth 50%. Po kështu po veprohet edhe për tremujorin e katërt, ku plani i prodhimit është 10.500 hl. Por që është vështirë të realizohet. Edhe në vitet e kaluara po t'u referohemi shifrave ka ngjarë e njëjta gjë.

Praktikisht për vitet 1961, 1962 dhe nëntëmujorin e vitit në vazhdim, birra është plotësuar si më poshtë:

**Viti 1961 në hl. Plan 45.000 Fakt 36.476**
**Viti 1962 në hl. Plan 45.000 Fakt 41.981**
**9/mujori i vitit 1963 Plan 34.000 Fakt 33.317**

Siç shihet, në asnjë nga periudhat e mësipërme plani i birrës nuk është realizuar plotësisht. Këtu kanë influencuar kryesisht tremujorët e parë dhe të katërt. Theksojmë gjithashtu se në çdo vit, në periudhën e verës, standardi në stazhionimin e birrës është shkelur, e cila ka influencuar në shije dhe në rezistencë duke pasur në shumë raste reklamime nga entet tregtare. Reklamimet kanë qenë për dy arsye:

1. Për prishje birre kur ajo ka qenë nën standarde në stazhionim dhe 2) për refuzim të enteve tregtare në kohën e ftohtë, të cilat nuk kanë pasur mundësi shitjeje. Kuptohet se për pikën e parë sikundër se thamë edhe më lart, shkelja e standardit në stazhionim ka ardhur si rezultat i mospërputhjes së planit të prodhimit në zierje me atë të shpërndarjes së birrës. Për dhjetëmujorin e këtij viti prej 15 korrikut deri më 30 tetor, për arsyet që thamë më sipër kemi shitur birrë të stazhionuar më pak se 15 ditë që është koha minimale e stazhionimi, 15.232 hl.

Duke krahasuar shifrat, nga njëra anë të prodhimit simpas shfrytëzimit të kapacitetit ekzistues të fabrikës në mënyrë ritmike dhe nga ana tjetër, të kërkesave për birrën nga entet konsumatore, ka propocione të tilla, të cilave ne me kapacitetet që disponojmë nuk mund t'i përgjigjemi.

Kjo, kryesisht sepse kërkesat e tyre nga një tremujor në tjetrin kanë diferenca të theksuara që nuk i përgjigjen kapacitetit të fabrikës. Për vitin 1963 plani i prodhimit që u përgjigjet afërsisht kërkesave të konsumatorëve në tremujorin e parë, dytë, tretë dhe të katërt, janë respektivisht nga 7.000, 12.5000, 15.000, dhe 10.500, hl. Siç shihet, vetëm në tremujorin e dytë përputhet plani i prodhimit me kapacitetin ekzistues, ndërsa në tremujorin e tretë, është mbi kapacitetin e fabrikës. Tremujori i parë dhe i katërt kuptohet se nuk shfrytëzohet plotësisht kapaciteti, duke na detyruar të pezullojmë zierjet për disa ditë të tëra. Duhet thënë gjithashtu se për tremujorin e parë të këtij viti ne nuk plotësuam as 7.000 hl. birrë që ishte plani por vetëm 5.930 hl. Duke bërë vetëm 60 zierje nga 170 që ishin planifikuar simpas kapacitetit nominal. Po kështu po ndodh edhe për tremujorin e katërt, ku plani i prodhimit megjithëse është më i vogël se kapaciteti ekzistues, nuk realizohet për shkak të refuzimeve të bëra nga entet tregtare, duke na detyruar përsëri të pezullojmë zierjet, të cilat në fabrikën e birrës janë bazë për plotësimin e planit. Shpjegojmë këtu se pezullimi i zierjes në tremujorin e parë dhe të katërt na detyron për arsye vendit të ngushtë që ekziston në rezervuarët e stazhionimit të birrës, të cilat kapacitetin maksimal e kanë deri në 4.900 hl.

Si rrjedhim i refuzimeve të enteve tregtare, të cilat kryesisht bëhen në tremujorin e parë dhe të katërt, për këtë periudhë kemi një deficit në planin e shpërndarjes së birrës prej 1.594 hl. Poshtë po japim pasqyrën e realizimit të planit shpërndarjes. (Shiko faksimilen përkatëse).

Një ngjarje analoge si sipër ka ndodhur edhe vitet e kaluara. Kështu, për tremujorin e parë të vitit 1961 nga 7.000 hl. birrë që ka qenë plani i shpërndarjes, është plotësuar 6.200., ndërsa tremujori i katërt nga 11.000 është realizuar 7.561. Në vitin 1962 plani i shpërndarjes së birrës për tremujorin e parë është plotësuar 5.624 nga 7.000 hl. që ishte plani, ndërsa tremujori i katërt nga 11.000. është plotësuar 7.600 hl. Pra, vetëm nga krahasimi i këtyre shifrave mund të shihet se çfarë anomalish ndodhin në prodhim në përpjekje për realizimin e planit, duke na detyruar të punojmë jo ritmikisht, me fuqi punëtore të pamjaftueshme për tremujorin e dytë dhe të tretë dhe të pashfrytëzuar plotësisht për tremujorin e parë dhe të katërt. Kjo lejon pastaj dëmet që mund t'i vijnë ndërmarrjes nga ngritja e kostos, mosrealizimi i rendimentit dhe shumë gjëra të tjera që kanë lidhje me këtë problem.

E keqja më e madhe për këtë çështje është se shumë ndërmarrjeve për arsye se nuk kanë treg shitjeje, u prishet birra dhe kërkojnë pastaj me çfarëdolloj justifikimesh t'i shmangen së vërtetës që nuk mund ta shesin atë dhe pastaj ndodh që të na i kthejnë përsëri. Kështu, deri më 31 tetor të këtij viti nga ndërmarrjet tregtare na janë kthyer 404 hl. birrë të prishura. Kjo pavarësisht se për çfarë faji ndodh, fakti është se ekonomia popullore dëmtohet rëndë, duke marrë parasysh në radhë të parë se lënda e parë elb që përdoret është fond buke, duke mos marrë parasysh pastaj përdorimin e shumë materialeve të tjera, të cilat shpërdorohen. Duhet të themi me këtë rast se entet tregtare nuk mirëmbajnë birrën, simpas kushteve që përcakton standardi, sidomos përsa i përket ruajtjes në magazinë në temperatura prej 4 deri në 12 gradë celsius, edhe kjo loz rol në skadencën e birrës para kohe.

Mbi sa sipër, për të normalizuar prodhimin dhe shpërndarjen e birrës dhe për të evituar dëmet që eventualisht mund të ndodhin në të ardhmen, ne mendojmë të merren këto masa sipas këtyre varianteve:

### VARIANTI I PARË

Me kapacitetin ekzistues të ulet plani vjetor nga 45.000 hl. në 40.000 hl. me një ndarje në tremujorë:

I pari 6.000 hl., i dytë 13.000 hl., i treti 13.000. hl dhe i katërti 8.000 hl. Duhet thënë se kjo ndarje nuk i përgjigjet plotësisht realizimit ritmik të planit dhe shfrytëzimit normal të kapacitetit, mbasi si shihet nga një tremujor në tjetrin ka ndryshime, por megjithatë është shumë më pozitiv se ndarja e planit prej 45.000 hl. që ekziston sot dhe u përshtatet më realisht kërkesave të enteve tregtare. Me këtë ndarje nuk bëhet shkelje e standardit të birrës në stazhionim.

### VARIANTI I DYTË

Këtu mendojmë të bëjmë rritjen e kapacitetit të repartit të zierjes me anë të zgjerimit. Kjo do të lejojë zhdukjen e vendit të ngushtë që ekziston në zierje në kohën e verës (kur kërkesat për birrë janë të mëdha), me repartin e stazhionimit. Kuptohet se në tremujorin e parë dhe pjesërisht në të katërtin nuk do të shfrytëzohet kjo rritje, por do të plotësojë nevojat e tremujorit të dytë dhe të tretë. Për këtë variant mendojmë që plani të jetë 45.000 hl. Diferenca prej 5.000 hl. në krahasim me variantin e parë i shtohet tremujorit të dytë dhe të tretë. Këtë variant, të porositur edhe nga shoku ministër, po e studiojmë dhe po përgatisim projektin që së shpejti do ta paraqesim për aprovim.

### VARIANTI I TRETË

Ky variant konsiston në rritjen e kapacitetit të stazhionimit me anë të zgjerimit. Për këtë problem me perspektivë nga ana jonë kanë filluar studimet.

Për vitin 1964, ne mendojmë të zbatojmë variantin e parë, d.m.th. të zvogëlohet plani i prodhimit nga 45.000 hl. në 40.000 hl. Në këtë vit të fillojmë të vëmë në zbatim variantin e dytë duke zgjeruar zierjen dhe në përfundim të saj në vitin 1965 të vëmë në zbatim variantin e dytë, duke planifikuar prodhimin e birrës 45.000 hl. Vënia në zbatim e këtyre dy varianteve do të bëjë të mos shkelet standardi i birrës në stazhionim.

Mbi sa sipër, lutemi që të merren parasysh vërejtjet tona dhe për vitin 1964, plani i prodhimit të caktohet 40.000 hl. Kjo do të lejojë kushtet normale të prodhimit dhe shitjes së birrës dhe do të eliminonte dëmet.

Bashkangjitur po ju dërgojmë edhe një pasqyrë mbi sasinë e birrës së kthyer nga entet tregtare.

SEKRETARI I ORGANIZATËS SE PARTISE DREJTORI I NDERMARRJES
(Elise Toshi) (Sotir Tushi)

Opinioni i Ditës

# Qyteti, "moderniteti", normaliteti dhe përgjegjësia

Nga Përparim Kabo

## Qyteti dhe njeriu…

(vijon nga faqja 1)

…qytet, por ama qytet pa jetë, qytet i vdekur. Njerëzit që mund të jetojnë në një bashkësi ende të paurbanizuar si duhet dhe në të gjithë hapësirën e vet, ata që jetojnë në kushte të pamjaftueshme të garancive sociale të jetës, por që punojnë, kanë motive në jetë, ndërtojnë jetë komunitare, mbajnë përgjegjësi, orientohen nga zhvillimi, mendojnë për vete, por edhe për brezat që do të vijnë, ngrenë rendin civil dhe respektojnë të drejtën e përfaqësimit etj., etj., pikërisht këta njerëz quhen qytetarë paçka se ende qyteti u mungon, nuk është ai që duhet, normaliteti nuk është arritur, veçse ata janë të përgjegjshëm ndaj quhen me plot gojën qytetarët që përpiqen. Njeriu ishte para qytetit dhe jo qyteti para njeriut. Njeriu e projektoi idenë e qytetit dhe jo qyteti nga vetvetja si një strukturë e ngurtë krijoi qytetarët. Qytetet lindën nga nevoja e një jete të organizuar në komunitet, jete me gjallëri ekonomike, me lëvizje dhe transport, me sektor shërbimesh dhe jetë aktive sportive dhe artistike. Qytetet lindën dhe u zhvilluan sepse në qendër të motivimit njerëzor u qendërzuar jeta, zhvillimi dhe prosperiteti, rritja demografike dhe akomodimi i saj. Që kur lindën, ata mbajtën parasysh sigurimin e identitetit njerëzor komunitar dhe jo thjesht atë social e klasor. Me kalimin e kohës struktura ndryshoi. Identiteti social solli zonat preferenciale, rezidenciale, lagjet e të pasurve si i thonë në gjuhën e popullit, atje ku ajri është më i pastër, natyra e virgjër ose e rikrijuar me dekore natyrore të paguara si frëngu pulën, ku mbillen ullinj qindravjeçarë, shkurre dekorative dhe pemë ekzotike. Krijohen si të thuash oaze të një paqeje moderne. A thua se atje mendja krijon më shumë, më ndryshe dhe shndërrohet në një të tillë më pjellore. Iluzione, sa shumë iluzione ka krijuar në jetë të jetëve kjo ngasje për identitetin klasor apo social që krahas sendeve luksoze të përdorimit, kërkon të duket edhe me banesat, parqet apo natyrë të hapur si pronë e pasunorëve, rrëmbime dhe rrethime të peizazheve natyrore, ku nuk hyn dot njeriu i zakonshëm, madje edhe shikimi tij e ka të pamundur. Moderniteti si vetizolim. Mes njeriut dhe qytetit është një element jetësor që quhet siç edhe shkruan profesori i ekonomisë sociale dhe politike në Universitetin e Sienës, italiani Stefano Bartolini në librin e tij studimor titulluar "Manifesti Lumturisë"… "Hapësira në qytetin relacional" e citoj… "Relacionet (lexoje lidhjet njerëzore P.K) kanë nevojë, para së gjithash, për hapësira të përbashkëta të një cilësie të mirë. Ka disa të mira bazike që asnjë rritje ekonomike nuk mund të në i japë. Ajo që nevojitet është ndërhyrja e menjëhershme në peizazhin urban, në hapësirat e gjelbra, në sheshet, në zonat për këmbësorë dhe në qendrat sportive. *Mjedisi urban duhet të mundësojë takimin midis fqinjëve dhe të panjohurve në hapësirat publike për rreth banesave. Një lagje e zënë me hapësira private, por ku ka pak hapësira publike, të ndotura, të mbipopulluara apo të zbrazëta është një pengesë për relacionet (lidhjet njerëzore). …Ajo që duhet ndërtuar është ndjenja e realizmit, e përkatësisë dhe e vlerave të përbashkëta, dhe kjo kërkon hapësira publike cilësore. Qytetet europiane kanë qenë në fillim të ndërtuara rreth shesheve… Sipas urbanistëve, njerëzit janë të gatshëm të përshkojnë jo më shumë se tri blloqe në këmbë për të shkuar te parku i lagjes, e për pasojë, një fëmijë nuk mund të jetojë më larg se tri rrugica nga një park". (Stefano Bartolini… "Manifesti për Lumturinë - Si të kalohet nga shoqëria e kamjes në atë të mirqenies… botimi shqip faqe 183- botime përpjekja).*



***Europianizimi i qyteteve, si normalitet dhe zhvillim***

Kontinenti vjetër ka histori, traditë dhe kontribute për ndërtimin dhe zhvillimin e qyteteve. Ka site arkeologjike, që ende të befasojnë me mbetjet e vendbanimeve të hershme. Ka qytete që janë një harmoni e përkryer mes arkaikes dhe të konservuarës, mes peizazhit historik dhe ndërtimeve urbane masive, deri te godinat e kohës moderne kur arkitektura ka kombinuar gati në trill, mitiken, shkencën, artin dhe komunikimin urban. Kur shkon në Pragë, pjesa historike të magjeps, e paprekur, e respektuar e mbrojtur, e ruajtur (dhe jo e rruajtur nga privati) dhe e konsideruar. Në Paris çka ta befason syrin dhe ta mbush shpirtin kur shikon rrugëve që janë godinat e dikurshme. Madhështia e tyre, ambientet e brenda plot hapësirë dhe dritë, distancat mes tyre dhe harmonizimi me peizazhin natyror. Çfarë kontraston keq, janë ndërtimet e më vonshme, pa hapësirë, nguc e nguc, pa estetikë që mund t'i ketë qëndruar kohës. Si të thuash godina që janë plakur para kohe, 'vjetërsira në moshë të re', do ti quaja me shpoti. Kur shkon në Stamboll sheh edhe më keq. Dallon një modernitet pretencioz, që bashkëjeton me godina tejet të rrënuara, por që janë bërë të tilla sepse nuk janë mirëmbajtur dhe u është zënë fryma nga godinat e larta arrogante, grabitqare të hapësirave dhe të dritës. Një qytet që të lodh për shkak të zhgënjimit që të krijon brenda një kohe të shkurtër. Mjafton të lëvizësh në këmbë dhe të shohësh keqpërdorimin e hapësirave urbane, me apo pa qëllim, për interesa kohëshkurtra dhe fitime të majme dhe të kaplon zhgënjimi. Në Budapest zona e Peshtit si më e vjetra ka rruajtur parqet e gjera, godinat e fundshekullit XIX dhe fillim shekullit XX. Janë ndërtuar godina të reja banimi që kontrastojnë me parafabrikatet e kohës së komunizmit, por ajo që të bije në sy janë që hapësirat urbane dhe kriteret e planifikimit urban, kanë qenë zbatuar me shumë korrektesë edhe në atë periudhë, ku strehimi solli ato lloj ndërtesash që me kalimin e viteve sigurisht stonojnë. Një gjurmë e strehimit në regjimin që e falte banesën dhe nuk e shiste, por që në shumë vende si në RDGJ, Hungari, RFJ, Shqipëri etj., ajo praktikë zgjidhi problemet e kohës për strehimin e popullatës. Në Hungari pas viteve 1990 u zhvillua zona e Budës në kodrat e qyteti, me godina të ulëta, me mbajtjen e një raporti harmonik mes truallit të gjelbëruar dhe ndërtesës. E gjitha ajo zonë të fal paqe, qetësi, transport urban e shërbime normale dhe mbi të gjitha është e ndërtuar me rregull, pasi zonat ku ndërtohet fillimisht azhornohen me punime inxhinierike nëntokësore me kushte normale së paku për 100 vite. Më pas nisin ndërtimet dhe kur përfundon banesa, ti ke vetëm për të lidhur tubat e ujërave me magjestalin, tubin e gazit dhe internetin, energjinë elektrike dhe panelin diellor. Tek ne mbaron ndërtimi, pastaj çahet rruga trotuari dhe nis puna nga e para. Po si zhvillohen qytetet në Europën moderne të fundshekullit XX dhe shekullin XXI? A ka ndonjë dokument bazik? A ka rregulla, ligje dhe detyrime? A ka forume në nivel europian? Sigurisht që ka. Le t'i shohim më nga afër dhe të përpiqemi t'i lexojmë edhe në realitetin e vendit tone. Bashkimi Europian aplikon prej disa vjetësh ***"Kartën Europiane URBANE".***

***Ç'janë të drejtat urbane…***

Në thelbin e filozofisë së këtij, dokumenti është "Qyteti në Europë". Është e drejtë të pyesim. Pse në një vend si Shqipëria që kërkon të hapë negociatat për anëtarësimin në BE ky dokument mungon? Ai duhet të jetë në çdo zyrë bashkiaku, në këshillat bashkiake, në bibliotekat e universiteteve ku përgatiten inxhinierët, ndërtuesit, urbanistët, arkitektët, sociologët, antropologët, juristët dhe specialistët e ambientit. Në mënyrë të thjeshtëzuar do duhej të ishte doracak për çdo familje dhe qytetar që ka të drejtën e votës në Republikën e Shqipërisë. Moderniteti në sjellje lidhet me ligjshmërinë. Në këtë dokument janë përcaktuar të drejtat urbane të qytetarit dhe komunitetit. Le t'i listojmë: **1-Trasporti dhe lëvizja.** Me gjithë ndryshimet e realizuara dhe situatat e përmirësuara, lëvizja në qytetin e Tiranës ka ende probleme. Lëvizja është ende e paharmonizuar, ka kaotizëm dhe humbje kohe. Cilësia e transportit lë për të dëshiruar. Autobusët janë jashtë standardeve të BE-së, sepse blihen në tregje të lira dhe janë pa cilësi. Higjiena e tyre brenda është e ulët. Ndotja e ajrit prej tyre është e lartë. Shpeshtësia e qarkullimit nuk mjafton. Çdo mëngjes dimër e verë vihen re njerëz të shumtë që presin gjatë në stacione. E keqja është se shërbimi urban është e biznesit privat dhe nëse në mendësinë e drejtuesve të bashkisë (si edhe u shpreh një zv.kryetar) ka zënë vend mendësia 'po deshe hip, po deshe mos hip në autobus', një (para)gjykim i tillë tregon se nuk është kuptuar që lëvizja dhe transporti janë e drejtë dhe jo shërbim tregu privat. **2-Mjedisi dhe natyra në qytete.** Mjedisi mbrohet nga dëmtimet si edhe janë, ndotja, mbetjet urbane, keqpërdorimet që mund të vijnë nga industritë që punojnë me teknologji të prapambetura (rasti i Elbasanit që ende vazhdon), mungesa e projekteve afatmesme dhe afatgjata për "green city"-qyteti gjelbër, përdorimi energjive të prapambetura që lënë ndotje, automjetet që lëshojnë tymra dhe gazra, djegia në natyrë të hapur të mbetjeve dhe produkteve si plastika apo goma makinash për furrat e gëlqeres (rasti i Krujës) etj. Natyra në qytete nuk është një çështje dëshire, preference apo dhurate bashkiake. Është e drejtë urbane. Natyra mbrohet nga dëmtimet si janë prerjet e pemëve, zjarret masive (rasti Fierit vitin që kaloi) dëmtimi lumenjve ku shkatërrohen bengjet dhe shtretërit për nxjerrjen e inerteve. Në Shqipëri ende nuk është ndaluar kjo masakër. Nuk ka fabrika që me teknologji moderne thërrmojnë gurët në fraksione të çakullit sipas nevojave të industrisë së ndërtimit. Hedhja e mbetjeve në lumenj (frekuencë e lartë e gjendjes alarmante në shumë qytete të Shqipërisë) qofshin këto mbetje biologjike, por edhe struktura të rënda betoni apo mbetje urbane si plastika e tjera, që duan një kohë jashtëzakonisht të gjatë të përthithen e shndërrohen nga natyra. ***Natyrë e plagosur, shoqëri e plagosur. Natyrë e helmuar, jetë e helmuar. Natyrë e vrarë, breza që do të jenë në humnerën e mosjetesës.*** Do doja të ndalesha këtu vetëm në një fakt që lidhet me qytetin e Tiranës. Unë këtu kam lindur, jam rritur e shkolluar, po punoj dhe kontribuoj për më shumë se 40 vjet që nga mbarimi studimeve të larta në këtë qytet dhe më gjerë. Në parantezë duhet të themi se që nga Mesjeta e hershme, (koha e mbretërive) u kuptua se pa ujë të pijshëm dhe pa disiplinim të ujërave të zeza qyteti nuk ia del dot, jeta është e rrezikuar dhe sëmundjet infektive bënin kërdinë, murtaja, kolera, dizenteria etj., etj. Kështu u ndërtuan si kundërmasë Parisi, Londra, Berlini apo Varshava të nëndheshëm. Llagëmet e thella, fillimisht mbledhja e ujërave të zeza dhe derdhje në mënyrë të disiplinuar po në natyrë. Kjo fazë tashmë është kaluar. Kudo në BE ka impiante përpunimi që ndajnë te ujërat e zeza pjesën e ngurtë nga ujërat. Ujërat dezinfektohen dhe si ujë i pastër derdhet në natyrë. Kemi përvojën e Pogradecit me bashkëpunimin gjerman-qeveria shqiptare. Lipset që të ruhet ky investim dhe jo të largojmë inxhinierin specialist që erdhi nga Kanadaja dhe të shpiem atje militantin e partisë politike. Ka nisur edhe në Vlorë, por nuk është bitisur si duhet. Tirana, kryeqyteti vendit po shkon 1 milion banorë. Ata duan ujë të pijshëm 24 orë, ujë të pastër në rubineta, të pandotur as me minerale të rënda dhe as me ndotje bakteriale. Uji me ligj në Republikën e Shqipërisë është ushqim. Pra, ne që e konsumojmë duhet të mbrohemi me ligj si konsumatorë. Bovilla si ujësjellës u ndërtua në prag të vitit 1990. Aso kohe edhe 153 fshatra të Tiranës u lidhën me tubacione. Me të hyrë demokracia, e cila u keqkuptua si anarki, tubat u shkulën dhe u përdorën për të mbështetur hardhitë. Qytet pa ujë nuk ka. Qyteti me ujë të kufizuar është jo i pastër. Ai lë për të dëshiruar në higjienë, është një ambient i rrezikuar nga helmimet dhe përhapja e epidemive. Nëse ka një nismë të Bashkisë së Tiranës se me rritjen e çmimit të ujit të pijshëm që rëndon në xhepin e qytetarit, gjendja do ndryshojë dhe do zgjidhet furnizimi dhe cilësia e ujit të pijshëm, një arritje e tillë do na gëzonte. Veçse duhet transparencë. Sa të ardhura janë mbledhur në vitin e parë të aplikimit të çmimit të ri dhe si janë përkthyer në investim dhe ndryshim real e të prekshëm këta fonde? Përndryshe njerëzit do dyshojnë dhe kanë të drejtë. Do bëhen mosbesues dhe shkaku nuk janë ata. Kanë parapaguar dhe nuk po marrin kontravlerën si investim real. Tirana do zgjerohet thuhet nga kryetari Bashkisë së Tiranës, ndaj ne duhet t'i paraprijmë me ndërtime të reja. Po ku është ky studim demografiko-statistikor?! Rritja natyrore ka ➔

Opinioni i Ditës

# Lumturia psiko-biologjike dhe grimcat e saj

Nga Dr. Xhoi Jakaj

*(vijon nga faqja 1)*

...e pyesja veten, por nuk kam akoma përgjigjen e plotë, atëherë fillova të shfletoj libra dhe literaturë për këtë fenomen që ndodh brenda nesh dhe shoqëron rrugëtimin e tonë. Cilat janë disa pyetje që gjatë jetës na mundojnë të gjithëve ne, por në kohë të ndryshme? A jam i/e lumtur dhe si arrihet lumturia e plotë në jetë. A do të jem i/e lumtur kur të martohem dhe të bëhem me fëmijë? Po kur të rris fëmijët? A do të jem i/e lumtur kur të kem shtëpinë time? Sepse nuk ke dëshirë të jetosh me prindërit? A do të jem i lumtur kur ta kem një vend pune? Por realisht në punë më streson gjithçka e mezi e duroj punën, nuk kam punën që dëshiroj të bëj. A do të jem i lumtur kur... ku dhe si? Dhjetëra pyetje na mundojnë dhe sa më të ngritur intelektualisht jeni, aq më shumë shtohen pyetjet, dilemat, kërkesat për jetën dhe kjo disi e largon distancën e lumturisë së vërtetë, por gjatë rrugës hasim në grimca lumturie, të cilat lidhen me faktorë biologjikë, psikologjikë dhe jetësor të formave e përmasave të ndryshme: 1-Ëndërrimet dhe shpresat kontribuojnë në faktorin e lumturisë, a keni ëndërruar për një pushim në një vend interesant, për një makinë të re; a prisni dhe shpresoni se gjërat do të përmirësohen? Të gjithë njerëzit ëndërrojnë, presin dhe shpresojnë, dhe nganjëherë përpiqen të bëjnë realitet ëndrrat e tyre, pritjet dhe shpresat, sepse besojnë që realizimi i tyre do t'i bëjë ata të lumtur. Unë psh., kam muaj që pres dhe shpresoj për një vend pune, të cilin mendoj se e meritoj dhe kjo gjë më bën të thur ëndrra, të cilat ndodh që më emocionojnë e më sjellim një hare momenti, po a thua më bën kjo puna të lumtur? 2-Faktori i lumturisë dikton sjelljen tonë dhe na nxit të ndërmarrim veprime. Natyrisht, jo të gjitha veprimet përfundojnë me lumturi, por ne jemi gjithnjë në kërkim të saj. 3-Faktori lumturi është brenda jush. Ne jemi qenie shpirtërore në trup fizik. Pjesa shpirtërore është gjithmonë e lumtur, varet çfarë duam ne të nxjerrim në pah, por aty është faktori i lumturisë. Mendja dhe mendimet tona duhet të prodhojnë në thelb esencë lumturie dhe jo re të errëta që fshehin diellin brenda nesh, ato duhet t'i shpërndajmë, pasi bëjmë edhe njerëz të tjerë të lumtur. 4 - Ne kërkojmë lumturi jashtë, sepse shpesh besojmë se është atje, por në fakt është gjithmonë brenda nesh. Fillon nga brenda sa do ti t'i besosh vetes dhe ne e shoqërojmë lumturinë apo mërzitjet me ngjarjet, zotërimet dhe njerëzit e jashtëm, sukseset dhe arritjet, apo dështimet tona ndodh që t'i kërkojmë në faktorë të jashtëm dhe po atyre shpesh ua atribuojmë. 5-Pa marrë parasysh se çfarë aktiviteti kërkohet të realizojmë gjatë përditshmërisë tonë, në momentin që përjeton lumturi, ndodh diçka brenda nesh dhe kjo vjen falë çlirimit të adrenalinës që është proces biologjik psh., është emocion i mbërritjes në majën e një mali të lartë, ngrënia e një ëmbëlsire të shijshme, një provim që e mbyllim me rezultate, ose fitimi i lotarisë. Në të gjitha rastet ka një element të përbashkët që është gjithmonë i pranishëm, gëzimi i madh që shfaqim dhe që fare mirë mund ta konsiderojmë lumturi. Ama gjithnjë në kulmin e lumturisë, ka një ndërprerje të procesit të të menduarit, ka heshtje të brendshme dhe shqetësimet fshihen e ne biem në paqe. Kjo mund të zgjasë për një moment të shkurtër apo pak më të gjatë. Në këtë paqe të madhe ndihemi të lumtur. Nuk është objekti i fituar ose performanca e suksesshme që solli këtë ndjenjë. Është diçka e brendshme dhe e pavarur nga bota e jashtme, pra atë e kemi ne vetë në dorë. Lumturia është gjithmonë këtu, por ajo mbulohet nga mendimet, dëshirat dhe frika. Kjo e fundit shoqërohet me çlirimin e Noradrenalines, hormoni që e bën trupin tonë të përballojë ankthin e frikën e kur kjo ndodh, shqetësimi apo dëshira e arritur, ka zhdukje të përkohshme të këtyre mbulesave. Egoja dhe personaliteti ndalojnë lëvizjen për një kohë dhe përjetohet një ndjenjë e madhe kënaqësie dhe lumturie. Por a është mundur lumturia e plotë? Mendimtarë, psikolog, sociolog dhe fizioterapeutet e mbarë botës thonë që gjatë veprimtarisë jetësore ne takojmë copëza lumturie, që përplotësojnë tablonë e plotë të jetës në të gjitha etapat e saj... Përpiquni të gjeni këto pikëza të vogla lumturie, t'i mbani fort dhe sa më gjatë afër vetes.



Doktoreshe shkencash, autore librash

← rënë. Mjafton të shohësh të dhënat e dy spitaleve obstetrik-gjinekologjik. Sipas kësaj ecurie, pas 20 vjetësh Tirana do ketë më pak fëmijë dhe më pak popullsi. Nuk llogarisim dhe të ikurit në emigracion. Le të shohim edhe një aspekt tjetër. Trajtimi ujërave të zeza në Tiranë. Përmes tubacioneve, ato derdhen në lumin e Lanës dhe më tej në lumenj që përfundojnë në det. Kështu do vazhdohet? Sipas profesor Eqerem Çabejit, lumi u quajt Lan-Lana sepse në ujin e pastër të tij, gratë e Tiranës lanin teshat, ndaj u quajt kështu, Lana. Po tani si ta quajmë? Lumi i gjirizit? Unë kam një pyetje për të gjithë ish-kryebashkiakët dhe këtë aktualin zotin, Erion Veliaj. Qeveria japoneze me një investim 300 milionë dollarë do të mbështeste një masterplan, realizmi i të cilit do të zgjaste deri në vitin 2021 dhe që do të shërbente për disiplinimin e ujërave të zeza të Tiranës dhe zonave për rreth. Përfshihen në këtë disiplinim inxhinierik nëntokësor, ndërtimi 184 km linjë tubacionesh kryesore dhe sekondare, si dhe 20,6 km tubacione kolektorësh (mbledhësish) si dhe dy stacioneve të pompimit dhe të pastrimit. Pra, ishte një projekt 15- vjeçar. Unë si qytetar po ju pyes publikisht ju zotërinj Albert Brojka, Edi Rama, Lulëzim Basha, Erion Velija... Ju lutem dini gjë a nisi ky projekt, a u lëvruan këta fonde? Nëse po, ku kanë shkuar? Ku janë km e tubacioneve? Ku janë stacionet e pompimit? Ku janë fabrikat e pastrimit (defekalizimit ku pjesa e ngurtë e briketuar shkon ose si pleh në bujqësi ose si lëndë djegëse në furra (fatkeqësisht edhe në Vlorë kjo faza përmbyllëse nuk u bë realitet)? Dini gjë ju për këto 300 milionë dollarët? Unë mund dhe do të pyes edhe në Japoni. Një gjë dua t'ju them si qytetar, por më shumë juve, kryetarit aktual. Nuk ka qytet modern që nuk disiplinon ujërat e zeza, por vazhdon t'i derdhi ata në lumenj apo në dete. Tirana lundron mbi ujëra të zeza, madje edhe atje ku janë ndërtuar vilat qindra mijëra euroshe dhe me gropat septike në anë të murit asgjë nuk është zgjidhur. Kutërbon era e ujërave të zeza. Jo për gjë, por ata që i kanë blerë kanë marrë dhe kredi të trasha e u duhen vite t'i shlyejnë... janë mashtruar dhe bankat nga ujërat e zeza. **3-Forma fizike e qyteteve.** Te ne flitet për rilindje urbane dhe ka ndryshime reale e të prekshme në hyrjet dhe qendrat e qyteteve, por këtë term nuk e dëgjojmë. **4-Trashëgimia urbane arkitekturore. Kush mban përgjegjësi për këtë pasuri që është e drejtë urbane e qytetarit. Ku prishet dhe ku ndërtohet, çfarë mbahet e konservohet, rinovohet dhe rikonstruktohet dhe çfarë shembet pa dhënë llogari në Shqipëri?** Tek ne ka ikje të kithta nga përgjegjësia. Mbrohen dhe rinovohen bodrume dhe shpi me gjethe, por quhet kalbësirë, magazinë, vjetërsirë, e përdalë fashiste godina e Teatrit Kombëtar. Unë jam me arkitektin Maks Velo, që u shpreh: "Sa më e vjetër që të jetë godina, aq edhe më e vlertë është". Nëse ne jemi një shumicë që e mbrojmë atë godinë, ne ia dimë plagët, mangësitë dhe mungesat thelbësore. Ne duam jo një, por shumë teatro të rinj. Vetëm Filanda ka mbi 80-të të tillë. Le të ndërtojmë dhe ne nja 8 apo 18-të... Por gjithashtu të mbajmë dhe rinovojmë këta që kemi. Isha në natën inauguruese të restaurimit të teatrit veror te Liqeni artificial i Tiranës. Një punë e mirë dhe me vlera. Në fjalën e hapjes, kryetari Bashkisë së Tiranës, zoti Erion Veliaj u shpreh: "Sot pashë një foto të vitit 1985 kur me prindërit, fëmijë, isha në këto shkallë. M'u ngjallën shumë emocione. Sonte amfiteatri është i rinovuar duke ruajtur identitetin, sepse investimet bëhen edhe për të mbajtur të gjallë kujtesën". Më pëlqyen ato fjalë, por se paskërkan qenë pjesore. Nuk vlekërkan në rastin e godinës së Teatrit Kombëtar. Disa të drejta të tjera që përfshihen në Kartën Europiane Urbane janë. 5-Strehimi. 6-Sigurimi urban dhe parandalimi i krimit. 7-Kujdesi ndaj personave me probleme dhe të paaftët në qytete. 8. Sporti dhe koha e lirë në qytete. 9-Kultura në qytete. 10-Integrimi kulturor në qytete. 11-Shëndeti në qytete. 12-Pjesmarrja qytetare, menaxhimi urban dhe planifikimi urban. 13-Zhvillimi ekonomik në qytete.

Karta europiane urbane është ndërtuar në Këshilli Europës për politikat urbane. Në funksion të tyre dhe në mbrojtje të të drejtave të qytetarit dhe komunitetit, si dhe të interesave publike funksionon (CLRAE) - Konferenca e Përhershme e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale e Europës. Në Europën ku ne duam të shkojmë, nuk mjafton as reforma administrative dhe territoriale, as punët dhe praktikat e mira në nivel lokal, as hapjet dhe mbylljet e rrugëve, as kumbullat e kuqe, as korsia e biçikletave. Atje shkohet kur e meriton dhe në aspektin e planifikimit hapësinor, kërkohet jo thjesht hartimi ligjit, që ne e kemi kryer rreth një dekadë më parë, porse të respektohen të drejtat urbane si korpus që bën pjesë në liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Qyteti mund të ndryshojnë, por ama nuk mund të privatizohet, kjo duhet shkruar në shumë zyra, rrugë e sheshe të atdheut tonë që ai të mos mbetet qytet europian në mundësi. Historia vazhdon...!

## HOROSKOPI

### DASHI
Ka të ngjarë që të merrni një lajm të lumtur. Megjithatë, disa çështje në pritje bëhen më të zymta dhe shpenzimet ndërkohë rriten. Mos lejoni që të afërmit dhe miqtë tuaj të menaxhojnë financat tuaja, sepse së shpejti mund të tejkaloni buxhetin.

### DEMI
Sot rrezikoni të keni probleme në dashuri. Mos u shqetësoni, sepse gjithçka do të ndryshojë me kalimin e kohës. Parashikohen disa përparime profesionale për disa nga të lindurit në shenjën tuaj. Jo një ditë shumë e mirë për të udhëtuar.

### BINJAKET
Duhet ta përmbani veten nga një zemërim i pakontrolluar. Një punë e rëndësishme do të ndalet për shkak të pozicionit të zymtë financiar. Njerëzit me të cilët jetoni nuk do të jenë shumë të kënaqur me ju, pavarësisht se çfarë bëni për t'i kënaqur ata.

### GAFORJA
Sot mund të keni disa shqetësime të vogla për të cilat mund t'ju nevojitet që të shkoni në spital. Problemet e një miku mund t'ju bëjnë të ndiheni keq dhe të shqetësuar. Mund të keni probleme edhe në dashuri.

### LUANI
Një ditë e veçantë parashikohet për ju, sepse shëndeti të mirë do t'ju mundësojë të bëni diçka të jashtëzakonshme. Investimet e bëra sot do të rrisin prosperitetin tuaj dhe sigurinë financiare. Ditë e mirë për rekreacion dhe argëtim.

### VIRGJERESHA
Natyra juaj impulsive mund t'ju shkaktojë probleme serioze shëndetësore. Sot ju duhet të përqendroheni në çështjet që lidhen me tokën, pasuri të paluajtshme ose projekte kulturore. Planet e një udhëtimi mund të shtyhen për shkak të ndryshimeve të minutës së fundit.

### PESHORJA
Përpiquni të përmirësoni shëndetin dhe personalitetin e përgjithshëm për një jetë më të mirë. Ka shumë të ngjarë të bëni disa ndryshime të mëdha në shtëpi. Disa çështje sekrete mund t'ju shkatërrojnë reputacionin. Kolegët do t'ju kuptojnë më mirë sot se çdo ditë tjetër.

### AKREPI
Qëndrimet pesimiste duhet të shmangen, sepse jo vetëm që do të minimizojnë shanset tuaja, por edhe do të shqetësojë harmoninë e trupit. Financat përmirësohen më vonë gjatë ditës. Miqtë mund t'ju lënë në një moment kur keni nevojë më shumë për ta.

### SHIGJETARI
I dashuri juaj do të kërkojë përkushtim. Mos u vini nën presionin e të tjerëve kur merrni vendime të rëndësishme biznesi. Jini të sjellshëm dhe simpatik për cilindo që qëndron në rrugën tuaj.

### BRICJAPI
Mos shpenzoni shumë për argëtim dhe luks. Miqtë dhe të afërmit do t'ju zgjasin dorën për ndihmë në rast se do të keni nevojë. Nëse besoni se keni shumë kohë përpara, atëherë duhet të ndërmerrni hapat e nevojshëm për të arritur potencialin tuaj më të

### UJORI
Mbani nën kontroll sjelljen tuaj prej grindaveci, sepse mund t'ju dëmtojë marrëdhënien përgjithmonë. Investimet duhet të bëhen me një perspektivë afatgjatë. Mundohuni të mos thoni gjërat e gabuara në kohën e gabuar dhe të jeni të kujdesshëm për të mos dëmtuar ata që doni.

### PESHQIT
Një ditë kur buzëqeshja do të jetë përgjithmonë në fytyrë dhe të huajt do të duken të njohur. Dikush tek i cili besoni nuk do t'ju thotë gjithë të vërtetën. Aftësia juaj për të bindur të tjerët do t'ju ndihmojë të zgjidhni problemet që ju dalin përpara.

"Maqedonia e Veriut", nenet dhe dispozitat e paktit me Greqinë

# Qeveria maqedonase publikon në shqip marrëveshjen për emrin

## *Në pajtim me rezolutën e 8 prillit, ja çfarë përmban dokumenti*

Qeveria e Maqedonisë në prag të parapërgatitjeve për fushatën për referendumin për emrin ka nxjerrë edhe në shqip, marrëveshjen për emrin të nënshkruar më 17 qershor 2018 në Prespë midis qeverive të të dyja vendeve. Një kohë të gjatë marrëveshja ishte e publikuar vetëm në origjinal në anglisht dhe versioni në maqedonisht, ndërsa tani është përkthyer edhe në shqip. Më gjerësisht lexojeni se çfarë përmban marrëveshja në fjalë: Marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e marrëveshjes së përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve preambula pala e parë, Greqia (pala e parë) dhe pala e dytë, e cila ishte pranuar në Kombet e Bashkuara në pajtim me rezolutën 47/225 të 8 prillit 1993 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara "pala e dytë", të emëruara së bashku si "palët". Duke u thirrur në parimet dhe qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, Dokumentit përfundimtar të Helsinkit i vitit 1975, akteve relevante të Organizatës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe vlerat dhe parimet e Këshillit të Evropës. Të udhëhequra nga fryma dhe parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe dinjitetit. Duke iu përmbajtur dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe veçanërisht atyre të cilat kanë të bëjnë me obligimin e shteteve në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo shtet. Duke e theksuar angazhimin e tyre të plotë për parimet për moscenimin e kufijve dhe integritetit territorial të shteteve, të përfshirë në Dokumentin Përfundimtar të Helsinkit të vitit 1975. Duke e vërtetuar kufirin ekzistues ndërmjet tyre si kufi ndërkombëtar i përhershëm. Të pajtuar plotësisht për nevojën e përforcimit të paqes, stabilitetit, sigurisë dhe avancimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit në Evropën Juglindore. Me dëshirë që ta përforcojnë atmosferën e besimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore në Rajon dhe t'i ndërpresin në mënyrë të përhershme të gjitha qëndrimet armiqësore, të cilat do të mund të qëndrojnë ende dhe duke u pajtuar për nevojën e përmbajtjes nga irredentizmi dhe revizionizmi në cilëndo formë. Duke u thirrur në obligimin e tyre, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe të drejtën ndërkombëtare, nën çfarëdo preteksti dhe në çfarëdo forme, të mos përzihen në punët e brendshme dhe kompetencat e Palës tjetër. Duke e nënvizuar, gjithashtu, vlerën e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve dhe nevojën kontestet të zgjidhen në mënyrë të qetë, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara. Duke i zgjidhur dallimet në pajtim me Rezolutën 817 (1993) të 7 prillit 1993 dhe Rezolutën 845 (1993) të 18 qershorit 1993, të Këshillit të Sigurimit, si dhe nenin 5 të Marrëveshjes së Përkohshme të 13 shtatorit 1995 në mënyrë dinjitoze dhe të qëndrueshme, duke i pasur parasysh vlerën e çështjes dhe ndjeshmërisë së secilës palë. Duke e marrë parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 47/225 të 8 prillit 1993. Duke e pasur parasysh Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin e 13 tetorit 1995 për masat praktike të lidhura me Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin për vendosje të ndërsjellë të zyrave për lidhje në Shkup dhe Athinë të 20 tetorit 1995, si dhe procesin e Masave për ndërtimin e besimit. Duke e nënvizuar dëshirën e tyre të fuqishme për miqësi të ndërsjellë, fqinjësi të mirë dhe partneritet për bashkëpunim, me angazhim t'i përforcojnë, zgjerojnë dhe thellojnë marrëdhëniet e tyre bilaterale dhe të vendosin themele të forta për përforcimin dhe respektimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe për zhvillimin e bashkëpunimit të tyre bilateral. Duke kërkuar që ta përforcojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e vet bilateral dhe ta mbindërtojnë në nivel të partneritetit strategjik, në sferat e bujqësisë, mbrojtjes civile, mbrojtjes, ekonomisë, energjisë, mjedisit jetësor, industrisë, infrastrukturës, investimeve, marrëdhënieve politike, turizmit, tregtisë, bashkëpunimit tejkufitarë dhe transportit, duke i shfrytëzuar pastaj përfitimet nga Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit, u dakorduan si vijon:



**PJESA 1**

**ZGJIDHJA E DALLIMIT RRETH EMRIT, ÇËSHTJEVE TË PAPËRFUNDUARA LIDHUR ME TË NJËJTIN DHE PËRFORCIMI I MARRËDHËNIEVE TË FQINJËSISË SË MIRË**

**Neni 1**

**1.** Kjo Marrëveshje është përfundimtare dhe me hyrjen e saj në fuqi shfuqizohet Marrëveshja e përkohshme mes palëve, e nënshkruar në Nju Jork, më 13 shtator 1995.

**2.** Palët e pranuan si obligues rezultatin nga negociatat, të cilat u zhvilluan nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara, e të cilat Palët ishin të obliguara t'i udhëheqin në pajtim me Rezolutën 817 (1993) dhe Rezolutën 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe në pajtim me Marrëveshjen e përkohshme të vitit 1995.

**3.** Në pajtim me këto negociata, në mënyrë të ndërsjellë janë pranuar dhe dakorduar këto, si vijojnë:

a) Emri zyrtar i Palës së dytë do të jetë "Republika e Maqedonisë së Veriut", i cili do të jetë emër kushtetues i palës së dytë dhe do të përdoret ergaomnes, siç është paraparë me këtë marrëveshje. Emri i shkurtër i Palës së dytë do të jetë "Maqedonia e Veriut".

b) Shtetësia e palës së dytë do të jetë maqedonase/qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç do të shënohet në të gjitha dokumentet e udhëtimit.

c) Gjuha zyrtare e Palës së dytë do të jetë "gjuha maqedonase", siç është pranuar në Konferencën e tretë të KB-së për standardizimin e emrave gjeografike, e mbajtur në Athinë në vitin 1977 dhe siç është e përshkruar në nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i kësaj marrëveshje.

ç) Termet "Maqedonia" dhe "maqedonase" e kanë domethënien e dhënë në nenin 7 të kësaj marrëveshje.

d) Kodi i vendit në targat e regjistrimit të automjeteve të Palës së dytë do të jetë NM ose NMK. Për të gjitha qëllimet tjera, kodi i vendit mbetet MK dhe MKD, siç është e përcaktuar zyrtarisht nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).

dh) Mbiemri lidhur me shtetin, organet e tij zyrtare dhe institucionet tjera publike do të jenë në pajtim me emrin zyrtar të Palës së dytë ose me emrin e tij të shkurtër, përkatësisht "të Republikës së Maqedonisë së Veriut" ose "të Maqedonisë së Veriut". Përdorime të tjera të mbiemrit, duke përfshirë edhe ato lidhur me entitetet dhe aktorët privatë, të cilët janë të lidhur me shtetin dhe entitetet publike, që nuk janë të themeluara me ligj dhe nuk marrin mbështetje financiare nga shteti për aktivitete jashtë shtetit, mund të jenë në pajtim me nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4). Përdorimi i mbiemrit për aktivitete mund të jetë në pajtim me nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4). Kjo nuk ndikon në procesin e përcaktuar sipas nenit 1, paragrafi 3 (ë) dhe në emrat e përbërë të qyteteve që ekzistojnë në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

e) Pala e dytë do ta pranojë emrin "Republika e Maqedonisë së Veriut" si emër të saj zyrtar, si dhe termet e cekura në nenin 1, paragrafi (3), duke e zbatuar procedurën e brendshme e cila është e obligueshme dhe parevokueshme, që do të përfshijë miratimin e amendamentit të Kushtetutës, siç është përcaktuar me këtë marrëveshje.

ë) Lidhur me emrin e lartpërmendur dhe terminologjitë në emrat komerciale, markat tregtare dhe emrat e markave, Palët pajtohen që t'i mbështesin dhe inkurajojnë komunitetet e tyre afariste që të vendosin dialog të sinqertë, të strukturuar dhe të mirë, në kuadër të të cilit do të kërkojnë dhe do të arrijnë zgjidhje të përbashkëta për çështje të cilat dalin nga emrat komerciale, marka tregtare dhe emrat e markave dhe për të gjitha çështjet relevante, në nivel bilateral dhe ndërkombëtar. Për zbatimin e dispozitave të lartpërmendura, do të formohet grup ndërkombëtar i ekspertëve, të cilin do ta përbëjnë përfaqësues të dy vendeve, në kontekst të Bashkimit Evropian (BE) me kontribuin përkatës të Kombeve të Bashkuara dhe ISO. Ky grup i ekspertëve do të formohet në vitin 2019, dhe do ta përfundojë punën e vet brenda tri vitesh. Asnjë dispozitë e nenit 1, paragrafi 3 (ë) nuk do të ndikojë mbi përdorimin e tanishëm komercial derisa nuk arrihet pajtim i ndërsjellë, siç është paraparë në këtë aline.

Në mënyrë të ngjashme, Pala e dytë do ta zbatojë këtë marrëveshje në pajtim me obligimet e saj të cilat rezultojnë nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi i saj në institucione ose organizata tjera ndërkombëtare, multilaterale ose rajonale si dhe ato në lidhje me Bashkimin Evropian, pas propozimit për anëtarësimin e saj.

4. Dispozitat e kësaj marrëveshje mbesin në fuqi në periudhë të papërcaktuar dhe janë të parevokueshme. Nuk lejohet asnjë ndryshim i dispozitave nga neni 1, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i kësaj marrëveshje.

5. Kjo marrëveshje do të regjistrohet në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga momenti i hyrjes në fuqi.

**NË DËSHMI TË KËSAJ,** Palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të angazhuar kompetentë, i kanë nënshkruar tre ekzemplarët e kësaj marrëveshjeje finale, në gjuhën angleze.

Përfaqësues i palës së parë, i bërë në Prespë, më 17 qershor 2018

---

**Pas 2 vitesh Turqia bën 'paqe' me Gjermaninë?**

# Presidenti turk, Erdogan do të takojë Merkelin në shtator

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan do të takohet me homologun gjerman, Frank-Ëalter Steimeier dhe kancelaren gjermane, Angela Merkel, gjatë vizitës zyrtare në Gjermani më 28 dhe 29 shtator, ka njoftuar dje presidenca gjermane. Erdogan do të pritet nga Steinmeier me nderime ushtarake, përpara se të marrë pjesë në një banket, që do të organizohet natën e 28 shtatorit, ka njoftuar presidenca, duke mos dhënë më shumë detaje. Agjenda e bisedimeve mes Erdoganit dhe Merkelit ende ka mbetur që të negociohet "në konsultim të ngushtë" me lidershipin turk, njoftuan zyrtarët gjermanë. Marrëdhëniet mes Berlinit dhe Ankarasë janë përkeqësuar që prej se Parlamenti gjerman në 2016, njohu si gjenocid, vrasjet masive të armenëve nga otomanët. Anëtarët e komunitetit kurd në Gjermani, kanë paralajmëruar protesta gjatë vizitës së Erdoganit në shtetin gjerman, për të shprehur pakënaqësitë e tyre lidhur me trajtimin e minoritetit kurd në Turqi.



## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. E famshmja Curie
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Kurosawa-s.
11. Është edhe ai i mendimeve.
12. Një mund të jetë zemërkau
13. Është dollapi.
14. Gjysmë mimoze.
15. Fillojnë sefte.
16. Ishte shkollë e Aristotelit.
20. Ndodh në kufij.
22. Bëhen me ambalazh.
23. Janë idhnakë.
25. Fillojnë titujt.
26. Do të bëhen pemë.
27. Ashtu si jeton heremiti.
29. Është dhomë e lartë.
30. Janë spanjolët dhe portugezët.
32. Ishte filozofi që preu damarët.
34. Janë gjuhë...veshi.
35. Musketierët e Dumas.
36. Lila këngëtare.
37. Kufizojnë takimet.
38. Ullmann aktore.
39. Mbledh baskët separatistë.
40. Fillojnë kapjen.
41. Inicialet e Delon.
43. Lumi i Bernës.
44. Është numri të parit.
45. Një thirrje me emra.

VERTIKAL
1. Farrow aktore.
2. Me Romeo në makinë.
3. Rolet pa zë.
4. Kufij itinerari.
5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
6. Në mes të dhomës.
7. Një tabu islamike
8. Mbyllin fushatat.
10. Janë festime
11. Lehar kompozitor.
12. Janë shtyllat për vela
14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
16. Duhen fituar me djersë.
17. Piktura pa kura.
18. Janë dokumente partie.
19. Në fund të vitit.
21. Farkëtoi armët e Akilit.
22. Një është për kërcim.
24. Athinaja e romakëve.
25. Janë kapriçiot.
27. Një tis mjegulle.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Edwards regjisor.
33. Parker regjisor.
38. Luan në kufij
39. Inicialet e Rohmer.
42. Fillojnë detyrën.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Lama i Tibetit.
5. Janë vendet e lira
11. Martin i Jack London.
13. Comaneci e famshme e gjimanstikës.
15. Ekstreme në sirtar.
16. Janë princër arabë.
17. Një treshe në skenë.
19. Një provë inteligjence.
21. Gjysmë tatimi.
23. Gjysmë eolike.
24. Ekstreme në studim.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Ndal në kufij
29. Kaluar në krye.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Është zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.
40. Janë galeri në rrugë.
41. Ramazzotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Është pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë kandil
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Nuk shuhej dot nga Tantali.
51. Janë thëniet e njerëzve të famshëm.
52. Qendër fitimi

VERTIKAL
1. Është halli.
2. Fillon me rruga...
3. Kastile janë në fund
4. Janë në skaje
6. Është vendi aderues
7. Ka kryeqytet Doha.
8. Incialet e Daudet.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Igli te Lazio.
12. Janë zjarrvënës.
14. Flanders e Defoe.
18. Shkroi Rinoceronti.
20. Ekstreme në slam.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Është llogarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Është melodramë.
40. Një thirrje e dëshiruar nga maja e direkut.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Në krye të njerëzve.
48. Sikur janë në krye.
49. Inicialet e Taylor që qe aktore..



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | | 6 | | | | 9 | |
| | 8 | | | 3 | | | | 2 |
| 5 | | 7 | | | | | | 4 |
| 1 | 2 | | | | | | 7 | |
| | | | 1 | | | | 5 | |
| 9 | | | | | 8 | | | |
| | | 2 | | | 3 | 4 | | 1 |
| 6 | 5 | 1 | | | | | | 7 |
| | | | | | | | 6 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 7 | 1 | 4 | 2 | 8 | 3 | 9 | 5 |
| 2 | 5 | 4 | 3 | 6 | 9 | 7 | 8 | 1 |
| 9 | 3 | 8 | 1 | 5 | 7 | 6 | 2 | 4 |
| 5 | 8 | 9 | 6 | 3 | 4 | 1 | 7 | 2 |
| 3 | 1 | 6 | 8 | 7 | 2 | 4 | 5 | 9 |
| 7 | 4 | 2 | 5 | 9 | 1 | 8 | 3 | 6 |
| 8 | 2 | 5 | 7 | 4 | 6 | 9 | 1 | 3 |
| 1 | 6 | 3 | 9 | 8 | 5 | 2 | 4 | 7 |
| 4 | 9 | 7 | 2 | 1 | 3 | 5 | 6 | 8 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | R | M | A | N | D | | | | L | I | N | D | A |
| V | A | J | I | | E | M | | V | E | K | | | L |
| A | D | E | N | | L | A | K | E | | O | A | Z | E |
| T | A | K | | M | I | L | I | T | A | N | T | E | T |
| A | | | P | I | R | A | M | I | D | A | L | E | |
| R | A | F | I | N | E | R | I | T | E | | E | | L |
| | F | A | N | A | T | I | K | E | T | | T | H | I |
| D | E | N | A | R | | A | E | | | G | | E | G |
| E | | A | | J | E | | | H | E | R | O | N | J |
| M | A | R | I | A | N | A | P | I | N | E | D | A | |
| E | T | E | R | | E | T | I | K | E | T | A | | A |
| K | A | T | A | R | A | K | T | | T | A | T | I | M |

FJALËKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | D | A | M | I | | R | E | F | O | R | M | A | T |
| R | E | K | O | R | D | | M | E | N | E | L | A | U |
| S | R | T | | P | E | K | I | N | | M | | | R |
| E | R | O | S | | K | A | N | O | T | A | Z | H | I |
| N | I | R | | P | O | L | E | M | I | K | A | T | |
| E | C | | P | E | R | I | M | E | T | E | R | | M |
| | K | R | I | J | I | M | | N | A | | A | T | E |
| E | | I | K | | M | T | | I | N | G | R | I | D |
| M | A | T | E | R | I | A | L | | I | L | I | G | U |
| I | N | A | T | I | | R | U | M | | O | | A | Z |
| L | E | | | G | J | E | N | I | U | | U | N | A |
| E | T | E | | A | L | T | A | R | E | T | | I | T |

## Argëtim filozofik



- Varësia e opinioneve, e shëndërruar në instinkt falë zakonit, çon drejt asaj që quhet forcë karakteri.

- Më e lavdërueshme është ajo grua, emri i së cilës shqiptohet më pak nga buzët e burrave, qoftë për lëvdata, qoftë për sharje.

- Të gjithë janë në gjendje të nxjerrin përfundime, pak janë gjendje të gjykojnë.

## KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 6 | | 8 | 3 | 6 | 10 | | 10 | 4 | 16 | 3 | 2 |
| 10 | 3 | 9 | 5 | 7 | 4 | | 8 | | | 6 | 12 | 4 |
| 4 | 4 | | 19 | 4 | 11 | 1 | 2 | 3 | 18 | 5 | 2 | |
| 18 | | 11 | 5 | 6 | 5 | 13 | 5 | 9 | 4 | 7 | 3 | 2 |
| 5 | 12 | 3 | 2 | 5 | 6 | 3 | 2 | | 9 | 5 | | 5 |
| | | 6 | 4 | 2 | 4 | | 17 | | 4 | 1 | 5 | |
| 5 | 2 | 3 | | 3 | 7 | | 2 | 5 | | 4 | 6 | 1 |
| 13 | 3 | 12 | 3 | 2 | 3 | | 4 | 2 | 5 | 13 | 5 | |
| 2 | 13 | 16 | | | 2 | 3 E | | 5 | 12 | | 2 | 5 |
| 17 | 12 | 4 | 1 | 12 | | 7 M | 6 | | | 2 | | 13 |
| 5 | 4 | | 7 | 4 | 8 | 4 I | 1 | 12 | 5 | 6 | 4 | 2 |
| 9 | 13 | 8 | | 2 | 17 | 6 R | 4 | 8 | 2 | 3 | 2 | |

## KRIPTOSKEME

### Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | U | P | A | | I | K | | K | U | R | S | I |
| A | P | E | R | A | T | U | R | A | | | H | K |
| T | | T | O | P | A | T | | P | A | P | A | S |
| | K | E | M | A | L | | T | A | K | A | | I |
| P | A | R | E | T | I | | T | R | U | R | I | |
| | R | P | | I | A | M | | E | L | I | A | S |
| E | T | A | T | | | E | | T | L | S | | H |
| P | O | N | Y | | E | R | I | | | I | U | T |
| I | L | | T | Y | M | I | | E | M | | K | E |
| T | I | R | A | N | E | T | | R | I | M | A | T |
| E | N | | T | I | T | A | N | I | K | E | | E |
| T | A | U | | | E | T | | K | U | R | A | T |

## Thënie të mençura

- Shpesh ne kundërshtojmë opinionin, ndërsa nuk na pëlqen vetëm toni me të cilën është shprehur ai.
- Personat që na japin besimin e tyre të plotë kujtojnë se kanë fituar kështu të drejtën që edhe ne t'u japim besimin tonë.
- Shumë premtime ulin besimin.
- Ai që lufton mund të humbasë, por ai që nuk lufton, është i humbur.
- Personave që nuk i duam ua llogarisim mirësjelljet që shfaqin ndaj nesh si fyerje.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al